

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi IX - Nr. 4 ... drejtësi për të gjithë



VJETORI I POLICISË SË KOSOVËS



15 vjet me policinë tuaj

Me respektin ndaj detyrës dhe uniformës mbrohet rendi dhe ligji në Kosovë

Me 6 shtator të vitit 1999, për herë të parë në rrugët e kryeqytetit të Kosovës u panë uniformat e kaltra të Policisë së Kosovës që atë kohë emëroheshin si Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK).

Këta ishin pjesëtarët e rinj të Policisë së Kosovës, policisë më të re në rajon dhe më gjerë.

Në një vend pothuajse pa institucione vendore, ne morëm përsipër sigurinë e qytetarëve, jetës dhe pronës së tyre si dhe ruajtjen e objekteve me rëndësi të veçantë. Pa dyshim se zyrtarët e gjeneratës së parë të Policisë së Kosovës janë ata të cilët me nostalgji i kujtojnë ditët e para të punës së tyre në vitin 1999. Në mungesë të infrastrukturës ligjore, në mungesë edhe të shumë pajisjeve elementare, por me një motiv dhe kurajë që ishte për lakmi, ne vazhduam rrugëtimin tonë drejt rritjes së një policie demokratike që ofron siguri për të gjithë qytetarët kosovarë pa dallim, duke arritur epitetin dhe fuqinë që sot PK-ja të konsiderohet shtylla bazë e sigurisë në Kosovë dhe si një nga institucionet më të suksesshme në rrugëtimin e ndërtimit të shtetit të Republikës së Kosovës.

Patjetër duhet përmendur se ky avancim ka ardhur nga përkrahja e vazhdueshme e popullit të Kosovës, institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe miqve të Kosovës dhe popullit të saj. Gjatë këtyre pesëmbëdhjetë viteve të formimit, zhvillimit dhe rritjes së Policisë së Kosovës ka pasur opinione të ndryshme për ne por kryesorja është se ne gjithnjë kemi pasur besimin në vete besimin e palëkundur tek qytetarët e Kosovës, të cilëve në shkëmbim të besimit, ne me të gjitha forcat u kemi ofruar siguri të jetës dhe pronës së tyre. Policia e Kosovës gjithmonë ka punuar duke u bazuar në maksimumin se "Suksesi ynë është suksesi i qytetarëve të vendit, duke lartësuar bashkëpunimin e sinqertë dhe të mirëfilltë me qytetarët e vendit me tendencë të përforsimit të mëtutjeshëm për të vazhduar rrugëtimin e vendit drejt avancimit dhe kapjes së standardeve më të larta të policimit bashkëkohor. Nga viti 1999 e deri më tash, në kuadër të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike janë trajnuar dhe përgatitur dhjetëra gjenerata të Policisë së Kosovës dhe aktualisht Policia e Kosovës në kuadër të strukturave të saj numëron 8698 zyrtarë policorë dhe 1133 personel civil me një strukturë të përgatitur në vijën vertikale dhe horizontale, si dhe me një përvojë solide, duke i plotësuar standardet për t'u radhitur me policitë e rajonit dhe më gjerë. Përkushtimi dhe përkrahja e institucioneve vendore e ndërkombëtare dhe insistimi këmbëngulës i menaxhmentit dhe pjesëtarëve të PK-së ka bërë që tash pas pesëmbëdhjetë vjetëve kjo polici të disponojë me infrastrukturë dhe teknologji moderne, ashtu si policitë e tjera simotra në shtete të ndryshme të Evropës. Në vitin 2008 PK tashmë kishte kaluar pothuajse në të gjitha njësitet e saj tranzicionin dhe kishte marrë kompetencat nga policia e UNMIK-ut, duke u përgatitur të marrë përgjegjësit për sigurinë e shtetit të Kosovës, i cili synon integrim në strukturat e unioneve të shteteve të ndryshme evropiane dhe botërore. Puna policore dhe qasja ndaj qytetarit nga PK-ja respektohet në Kosovë. Këtë mund ta dëshmojmë me faktin se interesimi i të rinjve dhe të rejave për t'u punësuar në PK dhe për të shërbyer si zyrtar policor vazhdimisht është në rritje. Për çdo konkurs që hapet aplikimet janë në numër shumë të madh. Këtë vit ne kremtojmë 15 vjetorin e krijimit dhe ky përvjetor na gjen më profesional dhe të avancuar në shërbim të vendit tonë. Ta festojmë këtë përvjetor me urimin që secili vit të jetë vit i përbushjes në shkallë sa më të larta të misionit tonë.



Brahim Sadriu



Revistë e Policisë së Kosovës

Redaktor:

Brahim Sadriu

Botues:

ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie

me Publikun e PK-së

DPP - Prishtinë

Tel.: 038 5080 1237

Mob.: 045 266 252

E-mail:

brahim.sadriu@kosovopolicice.com

braimsadriu@gmail.com

Bashkëpunorë:

Mërgim Bekteshi

Shaban Osmanollaj

Mentor Cakolli

Merita Canolli

Dizajni:

Çajup Kajtazi

Lektor:

Leonora Fejzullahu - Ruhani

Fotograf:

Arbër Muhadri

VSAT: 1145/1046

çajup.kajtazi@kosovopolicice.com

webmaster@kosovopolicice.com

www.kosovopolicice.com

PËRMBAJTJA

<u>POLICIA E KOSOVËS KA FESTUAR 15 VJETORIN E THEMELIMIT, FAQE 4</u>
<u>DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS Z. SHPEND</u>
<u>MAXHUNI PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM PËR SIGURI</u>
<u>PUBLIKE TË POLICISË SË AUSTRISË Z. KONRAD KOGLER, FAQE 4</u>
<u>PËRKUJTOHET PËRVJETORI I TRETË I RËNIES SË HEROIT TË KOSOVËS</u>
<u>ENVER ZYMERIT, FAQE 5</u>
<u>“RRUGË TË MBARË DHE TË SIGURT GJATË PUSHIMEVE”, FAQE 5</u>
<u>POLICIA E KOSOVËS KA SHKATËRRUAR MBI 700 ARMË TË VOGLA DHE</u>
<u>TË LEHTA, FAQE 6</u>
<u>POLICIA E KOSOVËS DHE SHQIPËRISË ME PATRULLIM TË PËRBASHKËT</u>
<u>NË SEZONIN VEROR, FAQE 6</u>
<u>DHURO NJË PIKË GJAK, SHPËTO NJË JETË, FAQE 7</u>
<u>DY MEDALJE TË ARTA DHE NJË E ARGJENDTË, FAQE 8</u>
<u>MË MIRË TË PARANDALOSH SE SA TË SHËROSH, FAQE 8</u>
<u>SHOQATA E GRAVE TË POLICISË SË KOSOVËS PËRFAQËSOHET NË</u>
<u>KONFERENCËN RAJONALE TË GRAVE NË SEKTORIN PUBLIK TË SIGURISË,</u>
<u>FAQE 9</u>
<u>SHOQATA E GRAVE POLICE, FAQE 9</u>
<u>KOMITETI LOKAL PËR SIGURI PUBLIKE I KOMUNËS SË DRAGASHIT</u>
<u>ORGANIZON TAKIMIN E XII ME RADHË TË</u>
<u>KËSHILLIT EKZEKUTIV TË KSLP-VE, FAQE 10 – 11</u>
<u>POLICIA KUFITARE, ROLI DHE MBIKËQYRJA E KUFIRIT, FAQE 12-13</u>
<u>POLICIA E KOSOVËS KA FESTUAR 15 VJETORIN E THEMELIMIT, FAQE</u>
<u>14-15</u>
<u>AKADEMIA NDËRKOMBËTARE E ZBATIMIT TË LIGJIT NË BUDAPEST -</u>
<u>QENDËR ME VLERA TË LARTA TRAJNUESE, FAQE 16 – 17</u>
<u>DELIKUENCA E TË MITURVE, 18 – 19</u>
<u>RËNDËSIA E IDENTIFIKIMIT TË DOKUMENTEVE TË FALSIFIKUARA,</u>
<u>TRAJNIMI PËR IDENTIFIKIMIN E ORIGINELITIT TË TYRE, FAQE 20-21</u>
<u>OPERACIONE, FAQE 22-24</u>
<u>PORTRET, FAQE 25</u>
<u>KURIOZITETE, FAQE 26 – 27</u>
<u>FOTOLAJM, 28</u>

MË GJERËSISHT ➔

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të PK-së

Presidentja e Kosovës Jahjaga viziton Policinë e Kosovës

Presidentja e Kosovës vizitoi Policinë e Kosovës dhe shprehu përkrahjen e institucioneve të Kosovës për policinë e vendit në luftimin e kriminalitetit dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët e Kosovës

Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, me 14 gusht 2014 ka vizituar Policinë e Kosovës, ku është pritur me nderimet më të larta nga Garda e Nderit e Policisë. Në Policinë e Kosovës ajo është takuar me drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës zotëri Shpend Maxhuni si dhe drejtues të lartë të Policisë. Në takimin e presidentes Jahjaga dhe drejtorit të Policisë Maxhuni është biseduar për punën dhe angazhimin e Policisë së Kosovës në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë së përgjithshme të qytetarëve. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, zotëri Shpend Maxhuni e ka njoftuar presidenten Jahjaga për punën, aktivitetet dhe sfidat me të cilat përballlet Policia e Kosovës. Ai tha se pjesëtarët e Policisë së Kosovës po vazhdojnë përkushtimin e tyre për të ofruar sigurinë për të gjithë qytetarët e vendit. Drejtori i Përgjithshëm Maxhuni theksoi: "Policia e Kosovës është



një institucion i profesionalizuar dhe po kryen me përkushtim detyrat e tij në shërbim të qytetarëve të vendit. Edhe operacioni i fundit i arrestimit të personave të dyshuar për aktivitete terroriste ka dëshmuar përkushtimin e Policisë për garantimin e sigurisë në vend". Ndërsa presidentja e Republikës së Kosovës tha se vizita e saj në Policinë e Kosovës është një mbështetje institucionale për këtë mekanizëm shumë të rëndësishëm të sigurisë për të gjithë qytetarët e vendit. Ajo tha se Policia e Kosovës me përkushtimin dhe profesionalizmin e saj ka siguruar

mbështetjen e të gjithë qytetarëve të vendit. Presidentja Jahjaga tha: "Policia e Kosovës si institucion gjithëpërfshirës po bën punë të madhe në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë kombëtare dhe se institucionet e Kosovës i japin mbështetje Policisë së Kosovës në garantimin e rendit kushtetues të vendit. Presidentja Jahjaga e shoqëruar nga drejtori i Përgjithshëm Maxhuni bëri vizitë në Qendrën e Përgjimit, në Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit si dhe në Qendrën Operative të Drejtorisë së Përgjithshme.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni priti në takim drejtorin e Përgjithshëm për Siguri Publike të Policisë së Austrisë z. Konrad Kogler



Me 26.5.2014 drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni, me stafin e lartë menaxhues të PK-së, ka pritur në një takim zyrtar z. Konrad Kogler, drejtori i Përgjithshëm për Siguri Publike i Policisë së Austrisë dhe stafin e tij. Duke i uruar mirëseardhje në Policinë e Kosovës z. Shpend Maxhuni falënderoi për mbështetjen që shteti austriak, veçanërisht policia austriake, ka dhënë për Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit në mes të dy policive të

të dy vendeve. Policia e Kosovës tashmë ka dëshmuar veten se është e përgatitur të jetë pjesë e të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë policorë, si: Interpoli, Europoli etj. me qëllim parandalimin, luftimin e kriminalitetit si në vend, rajon dhe më gjerë, duke potencuar se Kosova nuk është më vend vetëm konsumues i sigurisë por edhe prodhues i sigurisë për rajonin dhe më gjerë,

tha z. Maxhuni. Nga ana e tij z. Konrad Kogler, drejtor i Përgjithshëm për Siguri Publike i Policisë së Austrisë, falënderoi Policinë e Kosovës për bashkëpunimin me Policinë e Austrisë përmes zyrtarit ndërlidhës policor të Austrisë në Kosovës dhe se ky bashkëpunim do të rritet dhe do të lehtësohet edhe më shumë pas fillimit të punës edhe të zyrtarit ndërlidhës policor të Policisë

së Kosovës në Vjenë. Gjatë takimit, i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, të dy krerët e policive të të dy vendeve u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të dy policive si dhe avancimin e përbashkët në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit, krimit të organizuar dhe atij transkufitar.

Dekoratë nga shteti italian për drejtorin e Policisë së Kosovës

Në një takim zyrtar të organizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhuni ka pranuar medalje të argjendtë për meritë "Costantiniano Di San Giorgio". Shteti italian përmes misionit ushtarak të MSU-së italiane në Kosovë ia dorëzoi këtë medalje drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës z. Shpend Maxhunin në funksion të meritave të veçanta të tij si dhe të bashkëpunimit të treguar në mes të Policisë së Kosovës, karabinierëve italianë dhe policisë italiane. z. Maxhuni me këtë rast ka falënderuar shtetin italian për këtë vlerësim të lartë që i është bërë atij dhe Policisë së Kosovës si dhe ka vlerësuar kontributin dhe mbështetjen e dhënë përmes MSU-së italiane në Kosovë, të cilët përveç tjerash kanë realizuar trajnime të veçanta dhe donacione të ndryshme për Policinë e Kosovës.



"Rrugë të mbarë dhe të sigurt gjatë pushimeve"

Me 4.7.2014 në pikëkalimin kufitar në Merdare nga Policia e Kosovës, OSBE-ja dhe Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ) është lansuar fushata vetëdijesuese për pjesëmarrësit në komunikacion rrugor, me qëllim të respektimit të rregullave në komunikacion dhe parandalimin e aksidenteve rrugore, e emëruar "Rrugë të mbarë dhe të sigurt gjatë pushimeve". Kjo fushatë u referohet kryesisht bashkatdhetarëve tanë, të cilët pritet të vizitojnë Kosovën, dhe në vete ngërthen shpërndarjen e fletushkave me karakter informues për pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor. Në hapjen zyrtare të fushatës drejtori i Departamentit të Operacio-



neve nga Policia e Kosovës, z. Rashit Qalaj, duke falënderuar OSBE-në dhe FIQ-in për mbështetjen e fushatës tha:

"Kjo fushatë ka për qëllim vetëdijësimin e qytetarëve lidhur me rregullat e komunikacionit rrugor si dhe ruajtjen

dhe shpëtimin e jetës së qyteteve, duke parandaluar aksidentet në komunikacion. z. Carsten TWELMEIER – zëvendës drejtor i OSBE-së, duke iu referuar mesazhit të kampanjës “Rrugë të mbarë dhe të sigurt gjatë pushimeve”, tha se mbështetja e kësaj kampanje ka për qëllim krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë, duke

pasur në mendje se në këtë rrugë jemi të gjithë, mesazhi im për popullin për vizitorët e Kosovës është: mendoni një minutë për sjelljen tuaj në rrugë, tha në fjalën e tij z. TWELMEIER. Znj. Dajana Berisha, drejtore e ekzekutive e FIQ-it, duke treguar për bashkëpunimin në mes të FIQ-it dhe PK-së në fjalën e saj tha: “Siguria në komunitet është shumë

e rëndësishme dhe ka qenë dhe është edhe në fokus të punës së organizatës tonë. Duke qenë se kemi të bëjmë me sigurinë në komunikacion kjo ka qenë edhe arsyeja që ne nuk kemi hezitur për ta mbështetur këtë projekt”. Fushata ka zgjatur gjatë sezonit veror dhe fletushkat do të shpërndahen nëpër të gjitha pikëkalimet kufitare.

Policia e Kosovës ka shkatërruar mbi 700 armë të vogla dhe të lehta

Në Ditën Ndërkombëtare të Shkatërrimit të Armëve, Policia e Kosovës ka shkatërruar mbi 700 copë të armëve të vogla dhe të lehta. Armët e shkatërruara janë konfiskuar nga Policia e Kosovës gjatë punës së tyre gjatë hetimit të krimit.

Ky aktivitet është i realizuar në kuadër të Strategjisë të Kosovës për Kontrollin e Armëve dhe Planit të Veprimit, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe është mbështetur nga UNDP – projekti për Kontrollin e Armëve të Vogla në Kosovë (KOSSAC). Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, i cili ishte i pranishëm në këtë ngjarje, tha se shkatërrimi i armëve të paligjshme dhe të tepërta, përbën një element të rëndësishëm të Programit të Kontrollit të Armëve të Lehta dhe të Vogla të Kosovës.

“Kjo është një metodë efektive për reduktimin e numrit aktual të armëve në tregun e paligjshëm, si dhe parandalon furnizimin e mundshëm të armëve në tregun e paligjshëm”, tha ministri



Rexhepi. Me këtë rast, ai falënderoi Zyrën e Bashkimit Evropian, Qeverinë Gjermane për përkrahjen e tyre në këto aktivitete si dhe Programin Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara për kontributin e tyre të shkëlqyer dhe të vazhdueshëm. Ai shtoi se në kontrast me metodat e tjera në dispozicion të tilla si shitje ose dhuratë, shkatërrimi

siguron se AVL nuk do të gjejnë rrugën e tyre (përsëri) në tregun e paligjshëm dhe në këtë mënyrë mund të ndërtohet besim në përpjekjet e përgjithshme për të parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar tregtinë e tyre të paligjshme. Në këtë rast, gjithashtu morën pjesë zëvendës-përfaqësuesja e UNDP-së, Steliana Nedera, shefi i Zyrës së Bashkëpunimit të BE-së në Kosovë, Christof Stock dhe zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Naim Rexha.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare e Shkatërrimit të Armëve, disa vende në Ballkanin Perëndimor e shënuan këtë ditë duke shkatërruar armët e vogla dhe të lehta (AVL) si pjesë e një iniciative rajonale të koordinuar nëpërmjet Clearinghouse të Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC).

Reeth 1.500 armë janë konfiskuar në vit përmes disa aktiviteteve operacionale si dhe operacioneve të udhëhequra nga inteligjenca dhe raportimi i armëve të gjetura.

Policia e Kosovës dhe e Shqipërisë me patrullim të përbashkët në sezonin veror

Njësitë policore të Policisë së Kosovës në bashkëpunim me Policinë e Republikës së Shqipërisë, edhe këtë vit gjatë sezonit veror kanë patrulluar së bashku në akset rrugore, brenda territorit të Republikës së

Shqipërisë, duke filluar nga periudha kohore 1 korrik e deri në 31 gusht, kur edhe përfundon sezoni veror. Këtij bashkëpunimi i ka paraprirë nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit nga drejtorët e të dy agjencioneve

policore i Policisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë që këtë vit është bërë në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren me 28 qershor 2014. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes drejtori i Përgjithshëm i Poli-

cisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, ka thënë se ky aktivitet është bërë tradicional dhe se mbi bazën e vlerësimeve që dy policitë e dy shteteve kanë bërë, ka rezultuar se ka treguar suksese në shumë fusha e mbi të gjitha në fushën e komunikacionit rrugor.

“Qëllim i këtij aktiviteti do të jetë në shumë drejtime, duke filluar nga shkëmbimi i përvojave në mes të dy policive në fushën e policimit rrugor, pastaj mbështetja në parandalimin e ngjarjeve aksidentale, ku synim kryesor do të jetë ruajtja e jetës së njerëzve në qarkullim rrugor, fuqizimi i përgjithshëm i sigurisë në qarkullimin rrugor, pastaj do të jetë trajtimi i të gjithë shkelësve, apo kundërvajtësve të cilët në një mënyrë apo tjetër bien ndesh me rregullativën ligjore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe vlerësimet e përbashkëta që duhet pasuar nga të dyja policitë për të menaxhuar në mënyrë profesionale tërë këtë aktivitet, pra që do të realizohet nga dy policitë e dy vendeve”, ka thënë z. Maxhuni në fjalën e tij. Edhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shqipërisë, Artan Didi, tha se janë të përgatitur dhe se janë duke u munduar që t’u krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme që i duhen çdo turisti të zakonshëm. “Tashmë është bërë traditë bashkëpunimi i dy policive të fushës së qarkullimit rrugor edhe në vitet e mëparshme këto kanë dhënë rezultate pozitive sidomos në menaxhimin e trafikut, por edhe në trajtimin e shkeljeve të ndryshme, apo edhe në trajtimin e ngjarjeve të tjera aksidentale, të cilat kanë bërë që t’i



përgjigjem në një kohë më të shpejtë, të gjithë qytetarëve e sidomos përdoruesve të rrugës që vinë nga Kosova, duke shfrytëzuar bregdetin shqiptar. Është një sezon që ka një fluks të shtuar të mjeteve dhe ne jemi të përgatitur, por edhe jemi të interesuar që t’u krijojmë të gjitha lehtësitë e nevojshme pushuesve që vijnë nga Kosova dhe turistëve nga Kosova për të krijuar të gjitha ato lehtësirat e nevojshme që duhet t’i krijohen turistëve në përgjithësi”, ka thënë Didi. Implementimin dhe zbatimin në praktikë të kësaj marrëveshje do të bëjnë divizioni i komunikacionit rrugor i policisë së Kosovës me Drejtorinë e Policisë Rrugore të Republikës së Shqipërisë. Në takimin e mbajtur në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, të dy drejtorët kanë diskutuar edhe për vazhdimin dhe avancimin e bashkëpunimit edhe në fushat tjera, me qëllim koor-

dinimin e veprimeve në funksion të parandalimit të kriminalitetit në nivel të dy vendeve. Patrullimi i përbashkët nëpër rrugët e Shqipërisë, nga Policia e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë ka filluar me 1 korrik ku tri patrulla të Policisë së Kosovës, me gjashtë efektivë policie, u nisën drejt rrugëve të shtetit shqiptar dhe do të asistojnë Policinë e Shqipërisë deri me 31 gusht, kur pritet edhe të ulet fluksi i turistëve kosovarë, që zgjedhin bregdetin shqiptar për të pushuar. Patrullat do të ndërrohen çdo 10-të ditë, ndërsa do të jenë prezentë përveç Rrugës së Kombit edhe në të gjitha rrugët magjistrale. Nëpër rrugët e Shqipërisë do të patrollojnë njësitet e specializuara të Policisë së Kosovës, bën të ditur Sheremet Ahmeti, duke nënvizuar se njësitet e Policisë së Kosovës nuk do të kenë rol ekzekutiv, por do të asistojnë Policinë e Shqipërisë. Sekretari i sigurisë rrugore të Policisë së shtetit shqiptar Lefter Hysi, the se Rruga e Kombit, nën patrullimin e përbashkët të dy policive, do t’u shërbejë shtetasve kosovarë për të bërë pushime të sigurta, me qëllimin kryesor parandalimin e aksidentave dhe të incidenteve të mundshme.

Policia e Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me Policinë Rrugore të Shqipërisë, për t’u thënë stop aksidentave dhe rrezikshmërisë së përgjithshme të udhëtarëve në komunikacion.

Edhe përkundër faktit se kjo tashmë është bërë tradicionale qytetarët e mirëpresin vazhdimin e këtij bashkëpunimi, ndërsa policia bën thirrje për kujdes të shtuar në komunikacion.

Përkujtohet përvjetori i tretë i rënies së heroit të Kosovës Enver Zymerit

Në tre vjetorin e tretë të rënies në krye të detyrës të policit të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, Enver Zymeri në aksionin e 25 korrikut 2011, u vlerësua lart vepra e tij, duke e cilësuar si moment kyç në kthimin e integritetit territorial në gjithë territorin e Kosovës. Ministri i

Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi e quajti veprimin më të madh të pasluftës aksionin e 25 korrikut, i cili, sipas tij, mundësoi shtrirjen e sovranitetit në gjithë Kosovën. “Një veprim shumë i madh në kohën e pasluftës i cili ka shtrirë sovranitetin e Kosovës në tërë tërësinë e vet



territoriale", tha Rexhepi. Ndërsa, në anën tjetër, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni tha se përfundimisht 25 korriku i vitit 2011 është vula e integritetit dhe sovranitetit territorial. "Ne jemi kre-

narë si PK që në radhët tona ka rënë një pjesëtar i yni duke respektuar ligjin, duke ofruar siguri për vendin dhe duke shtrirë integritetin territorial në tërë Kosovën", theksoi Maxhuni. Me rastin e tre vjetorit të vrasjes së

policit Enver Zymeri, janë bërë homazhe edhe tek lapidari, familja e tij, si dhe u përurua objekti për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, ku do të jetë i vendosur kryesisht menaxhmenti i lartë i PK-së.

Dy medalje të arta dhe një e argjendtë

Në lojërat e para evropiane të Policisë dhe zjarrfikësve që gjatë këtij viti kanë marrë pjesë edhe një ekip në përbërje të dy pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, rreshter Anton Cena dhe zyrtari policor Xhavit Tahiri, të cilët në disiplinat që kanë garuar kanë arritur që t'i fitojnë 3 medalje, dy të arta dhe një e argjendtë. Pjesëtar i Policisë së Kosovës rreshter Anton Cena ka marrë dy medalje të arta, një medalje në kategorinë -66 kg M4 dhe M5 ndërsa medaljen tjetër në kategorinë



absolute. Në këtë garë ka marrë pjesë edhe pjesëtar i tjetër i Policisë së Kosovës atleti jonë i mirënjohur Xhavit Tahiri, zyrtar i NJSO-së nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicë, Mitrovica, i cili shkëlqeu në vrapimin në 800 metra, duke e marrë vendin e dytë pas pjesëmarrësit nga Gjermania. Edhe përkundër faktit se z. Anton Cena ishte i lënduar dhe kishte sugjerime nga mjeku që të mos garonte edhe kësaj radhe ai vazhdoi me maksimën e tij "Kurrë dhe kurrë mos u dorëzo"

Më mirë të parandalosh se sa të shërosh

Duke marrë parasysh sëmundjet me karakter global dhe me prognozat e këqija siç janë: sëmundjet e zemrës, të sheqerit, sëmundjet malinje etj. dhe rrezikun e atakimit edhe të zyrtarëve policorë nga këto sëmundje, Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore /DPP ka realizuar fushatat që janë konsideruar mjaft të suksesshme për promovimin e shëndetit të zyrtarëve policorë:

"Identifikimi i tensionit të lartë të gjakut dhe sëmundjes së sheqerit"

"A kam indikacion për Mamografi"

"Çrregullimet emocionale"

Fushata "Identifikimi i tensionit të lartë të gjakut dhe sëmundjes së sheqerit" është hapur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës për të vazhduar në të gjitha drejtoritë rajonale si në: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë duke shkuar edhe në kampin Vrella dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Në të gjitha vendet ka pasur shumë pjesëmarrës të interesuar.

Kjo fushatë ka pasur për qëllim zbulimin e hershëm të sëmundjes së sheqerit dhe tensionit të lartë të gjakut.

Aktivitetet që vlen t'i përmendim gjatë kësaj fushate janë: matjet e Glikemisë (sheqerit - me gjendje esëll), matjen e tensionit arterial, Anamneza Internistike (ankesat kryesore),

plotësimi të formularit për sëmundjen e sheqerit, dhënia e këshillave internistike mjekësore, në raste të caktuara aty për aty kemi pasur edhe rekomandime për terapi dhe për ekzaminime shtesë. Edhe prezenca e psikologut ka pasur shumë rëndësi. Pasi që janë identifikuar rastet janë bërë gati të gjithë formularët, janë shqyrtuar kërkesat dhe është përgatitur lista e kandidatëve potencial për sëmundje të sheqerit dhe tensionit të lartë të gjakut, për të cilët do të marrim masa adekuate mjekësore!

Po i përmendim disa prej faktorëve të rrezikut që ndikojnë në shfaqjen e sëmundjes së Diabetit: Stresi, mbipesha, gjenetika etj.

Në fund të aktivitetit për këtë fushatë janë shpërndarë edhe broshurat e përgatitura nga DSHSH për zyrtarët policorë.

Një fushatë tjetër mjaft me rëndësi dhe realizuar nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore/DPP është edhe fushata "A kam indikacion për Mamografi" për preventivën e kancerit të gjirit të gruas në Polici. Për këtë fushatë Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore ka përgatitur formularët të cilët janë shpërndarë për të gjitha femrat në polici, e pastaj pas plotësimit është shqyrtuar ky formular nga mjekët e DSHSH-së dhe është bërë seleksionimi i femrave që kanë rrezikshmëri për kancer të gjirit, për të mundësuar më tutje përmes

QKUK-së realizimin e Mamografisë. Fushata tjetër është realizuar përmes shpërndarjes së broshurës me titull "Çrregullimet emocionale" si dhe mbajtjes së ligjërates me temë të njëjtë. Ligjëratat për këtë temë janë mbajtur në DPP po ashtu edhe në të gjitha drejtoritë rajonale, përfshirë këtu edhe kampet e Njësiive Speciale. Qëllimi kryesor i kësaj fushate ka qenë parandalimi i çrregullimeve emocionale tek të gjithë punonjësit e PK-së duke marrë parasysh natyrën mjaft specifike me shumë stres psikik dhe rrezikshmëri në detyrë. Që të tria këto fushata e kanë pasur edhe rolin e vet specifik, ashtu siç janë edhe vetë sëmundjet. Nga secila kanë dalë informacione të mjaftueshme që mund të kontribuojnë në shëndet të mirë të secilit pjesëtar të PK-së.

CITAT NGA LIBRI I PËRSHTYPJEVE NË FUSHATË: "E përkrahi këtë iniciativë të fushatës për matje të sheqerit dhe tensionit dhe një veprim i mirë që duhet në vazhdimësi të përkrahet. Dhënia e këshillave mjekësore për ne pjesëtarët e PK-së ishte më se e mirëseardhur".

Krejt në fund kushdo që ka pasur dëshirë i ka shkruar përshtypjet e veta në "Librin e përshtypjeve 2014", që për ne është kënaqësi dhe motivim për më tutje.

Përgatitur nga:

**Dr. Linditë Kajtazi/Interniste
Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve
Shëndetësore /DPP**

Shoqata e grave të Policisë së Kosovës përfaqësohet në konferencën rajonale të grave në Sektorin Publik të Sigurisë

Në muajin maj të këtij viti në Budvë të Malit të Zi, misioni i OSBE-së në Kosovë me mbështetjen e misionit të OSBE-së, organizoi dhe mbajti konferencën rajonale "Gratë në sektorin e sigurisë publike" që mbledhi së bashku më shumë se 25 pjesëmarrës nga shtetet, si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova. Të gjithë ishin përfaqësues të sektorit të sigurisë, përkatësisht: Policisë, Parlamentit, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pjesëmarrësit u mbledhën që të flasin për përvojat dhe sfidat e tyre në sektorin e sigurisë publike dhe integrimin e perspektivës gjinore nëpër institucionet publike. Konferenca kishte për qëllim forcimin e rolit dhe pozitës së femrave në sektorin e sigurisë publike në nivel rajonal



dhe rritjen e bashkëpunimit reciprok. Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës pati rolin kyç gjatë kësaj konference ku u prezantua me një videospot në lidhje me themelimin, funksionalizimin dhe arsyet e formimit të një organizate si kjo, ndërsa në anën tjetër u paraqitën objektivat dhe sfidat të cilat shoqata i ka përballë saj. Shoqata u përfaqësua

denjësisht nga bordi i saj drejtues, siç janë: koordinatoret rajonale që vijnë nga të gjitha regjionet e Policisë së Kosovës dhe ky ishte një rast i mirë për ngritjen e kontakteve të reja në nivel rajonal si dhe shkëmbim i përvojave të dyanshme. Konferenca u përmbyll me rekomandime të hartuara që u fokusuan në zhvillimin e këtij rrjeti përkatës brenda pjesëmarrësve të kësaj konference, me qëllim për të punuar së bashku në fushat e identifikuar dhe për të këmbyer praktikatat më të mira që kontribuojnë në promovimin e rolit të grave dhe barazisë gjinore në sektorin e sigurisë publike. Kjo ngjarje ishte një vazhdim i mbështetjes së OSBE-së në promovimin e rëndësinë e barazisë gjinore në sektorin e sigurisë publike.

Shoqata e Grave Police

I AWP – Shoqata Ndërkombëtare e Grave Police u themelua në vitin 1915 dhe është organizata më e vjetër për gratë në profesion të drejtësisë penale ndërkombëtare. Qysh nga fillimet e saja të hershme, kjo organizatë punon për të forcuar, të bashkuar dhe për të ngritur profilin e femrave në profesionet e drejtësisë penale-sektorit të sigurisë. Konferenca Ndërkombëtare IAWP 2014 mbledh Shoqatat e Grave Police nga e gjithë bota, andaj konferenca e sivjetme do të mbahet në Winnipeg, Kanada dhe si qëllim ka bashkimin e komunitetit të zbatimit të ligjit dhe njëherësh për të festuar arritjet dhe për të rritur profilin e grave në zbatimin e ligjit, në mënyrë që kjo traditë e ndërtuar dhe e krijuar me dekada të tëra të mbesë si trashëgimi për gjeneratat e ardhshme. Krahas afro 600 delegatë që do të jenë pjesëmarrës nga e gjithë bota e që do të mbledhen për të ndarë përvojat e tyre dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në këtë fushë, edhe Shoqata e Grave



Police të Kosovës do përfaqësohet sivjet zyrtarisht për herë të parë si një trup i tillë dhe është planifikuar që të përfaqësohet me tre pjesëtarë të Policisë së Kosovës/Anëtare të Bordit Udhëheqës së kësaj shoqate, ku në takimet rajonale të parapara sipas agjendës së konferencës, shoqata do të bëjë një prezantim dhe do t'i paraqesë të arriturat e saja, arsyet e themelimit, objektivat, sfidat dhe planet që kontribuojnë në ngritjen e imazhit të grave në kuadër të kësaj organizate. Ndryshe, Shoqata e Grave të Policisë së

Kosovës në muajin qershor 2014, ka kompletuar tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe ka dorëzuar aplikacionin për anëtarësim në këtë organizatë ndërkombëtare. Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës punon në fuqizimin e rolit dhe imazhit të grave në Polici, promovon parimet e mosdiskriminimit në vendin e punës dhe ofron ndihmë në adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, avokon për ngritje të vetëdijes lidhur me këto çështje, nëpërmjet trajnimeve të organizuara ofron mbështetje të vazhdueshme për gratë në Polici e që ndikojnë në ngritje profesionale të tyre, kujdeset për mirëqenien shëndetësore dhe psiko-sociale të grave në polici dhe fundja vë në pah kontributin e grave në këtë organizatë dhe motivon vajzat e reja që t'i bashkëngjiten një profesioni të tillë. Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës në radhët e saja numëron afro 500 anëtarë staf i uniformuar, civil si dhe anëtarë meshkuj.

KOMITETI LOKAL PËR SIGURI PUBLIKE I KOMUNËS SË DRAGASHIT ORGANIZON TAKIMIN E XII ME RADHË TË KËSHILLIT EKZEKUTIV TË KSLP-ve

Në komunën e Prizrenit me datën 11.6.2014 është organizuar takimi i XII me radhë i Këshillit Ekzekutiv të Komiteteve Lokale për Siguri Publike me pjesëmarrje nga të gjitha KLSK-të e themeluara në Republikën e Kosovës

Ky takim organizohet dy herë në vit dhe ka për qëllim grumbullimin e të gjithë përfaqësuesve të KLSK-ve për të diskutuar sfidat, vështirësitë dhe progresin e arritur në përmirësimin e kushteve jetësore përmes avancimit të sigurisë në bashkësi dhe për të shkëmbyer përvojat e suksesshme të zbatimit të projekteve të ndryshme. Vlen të theksohet kontributi i jashtëzakonshëm i misionit të OSBE-së në Kosovë, Departamentit për Rënd dhe Siguri Publike, respektivisht Sektorit për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi në mbështetjen financiare të organizimit të këtij takimi.

Përveç pjesëmarrësve nga KLSK-të, në këtë takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit nga institucione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Ambasadori i misionit të OSBE-së në Kosovë Zt. Schlumberger ka vlerësuar lartë angazhimin e anëtarëve të Komiteteve Lokale për Siguri Publike në përmirësimin dhe ngritjen e sigurisë në bashkësitë prej nga ata vijnë ku ndër të tjera shtoi: "Jam shumë i lumtur që çdo ditë e më tepër janë duke u themeluar KLSK të reja në Kosovë me qëllim të identifikimit, adresimit dhe zgjidhjes së problemeve lokale bashkërisht me Policinë e Kosovës. Misioni i OSBE-së edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kontribuojë në promovimin dhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për ekzistimin e një forumi të tillë të sigurisë. Gjithashtu, misioni të cilin e përfaqësoj do të mbështetë anëtarët e KLSK-ve përmes ndërtimit të kapaciteteve me qëllim të realizimit të misionit të tyre për t'i shërbyer bashkësisë". Për më tepër, Ambasadori Schlumberger siguroi pjesëmarrësit se edhe në të ardhmen OSBE do të mundohet të gjejë donator të mundshëm për të përkrahë iniciativat dhe projektet e Komiteteve Lokale për Siguri Publike.

Vlen të theksohet se që nga viti 2013 përmes lehtësimit nga misioni i OSBE-së në Kosovë, Komitetet Lokale për Siguri Publike kanë përfituar një donacion



nga Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze për zbatimin e shumë projekteve dhe iniciativave të anëtarëve të KLSK-së, kryesisht rreth ngritjes së nivelit të sigurisë në bashkësi. Kjo mbështetje për KLSK-të nga këto institucione do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm.

Zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës për Operativë zotëri Naim Rexha duke e përshëndetur punën dhe kontributin vullnetar të anëtarëve të Komiteteve Lokale për Siguri Publike, ndër të tjera tha: "Më lejoni t'ju përgëzoj dhe të shpreh mirënjohjet më të sinqerta për punën dhe përkushtimin që po tregoni si anëtarë të këtij forumi të sigurisë i cili shërben për përmirësimin e sigurisë në vend si dhe avancimin e komunikimit të ndërsjellë polici-qytetarë. Në mënyrë që të përmirësohet edhe më tutje gjendja e përgjithshme e sigurisë në Republikën e Kosovës, të gjithë ne duhet të kuptojmë se vetëm Policia e Kosovës si e vetme nuk mund ta bëjë një gjë të tillë pa një bashkëpunim të besueshëm, të vazhdueshëm dhe të sinqertë me qytetarët. Siç tashmë jeni në dijeni se Strategjia dhe Planin e Veprimit 2012-2016 "Policimi në Bashkësi", respektivisht koncepti i policimit në bashkësi është duke u zbatuar në praktikë në tërë territorin e Republikës, duke synuar një shtrirje edhe më të gjerë jo vetëm brenda organizatës së Policisë së Kosovës. Në kuadër të këtij zbatimi të strategjisë është bërë edhe ndarja

sektoriale brenda stacioneve policore, ku qëllimi kryesor i këtyre sektorëve është afrimi me qytetarin, komunikimi më i avancuar dhe i mirëfilltë me qytetarin rreth problemeve dhe shqetësimeve që ata i kanë lidhur me sigurinë e lagjes apo bashkësisë së tyre, respektivisht zonës të cilës i përkasin me ndarjen policore si dhe problemet dhe brengat e qytetarëve përmes policëve të caktuar në sektorë të adresohen në instanca dhe institucione ku do të mund të arrihej një parandalim apo zgjidhje afatgjate".

Njëherësh zotëri Rexha ftoi të gjithë anëtarët e Komiteteve Lokale për Siguri Publike dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët në fushë-veprimtarinë e tyre kanë prioritet promovimin e sigurisë në bashkësi dhe sigurisë publike në përgjithësi, që të promovojnë të mirat dhe përparësitë e kësaj strategjie të policimit në bashkësi, me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek secili qytetarë dhe tek institucionet në përgjithësi.

Zotëri Rexha falënderoi Ambasadën e Mbretërisë Norvegjeze për përkrahjen financiare në zbatimin e projekteve të shumta të Komiteteve Lokale për Siguri Publike dhe misionin e OSBE-së në Kosovë për mbështetjen e vazhdueshme që po i bën konceptit të sigurisë në bashkësi në përgjithësi.

Në fund, zotëri Rexha duke iu uruar punë të mbarë në realizimin e qëllimeve që kanë KLSK-të shtoi: "Unë shpresoj se të gjithë e kuptojmë rëndësinë e një bashkëpunimi të shëndoshë në mes të policisë dhe qytetarëve, për të parandaluar krime të niveleve të ndryshme, sepse përmes kësaj qasjeje pro-aktive ne, Policia e Kosovës, do të shmangim paraqitjen e krimit e për më tepër bashkërisht do të evitojmë apo parandalojmë pasojat nga aktivitetet kriminale, të cilat shpeshherë mund të jenë edhe fatale për qytetarët".

Duke shprehur qëndrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës lidhur me

POLICIA KUFITARE, ROLI DHE MBIKËQYRJA E KUFIRIT


Pa dyshim se procesi i reformave integruese në të gjitha institucionet shoqërore, e në veçanti ato të policisë kufitare, kanë për detyrë ndërtimin e institucioneve dhe mekanizmeve funksionues për kontrollin e kufijve, në mënyrë të sigurt, duke përfshirë mbikëqyrjen kufitare si një koncept të avancuar, pasi sot ruajtja dhe mbikëqyrja e kufijve realizohet përmes kontrollit të mbikëqyrur në mënyrë efikase nga personeli i policisë kufitare, që në shumë vende demokratike kanë marrë epitetin e Rojës Kufitare.

Këtu procesi i emërimit është ndërtuar si mbikëqyrje dhe sektori për patrullim i vijës së gjelbër (në Shqipëri-kufiri jeshil) që në thelb kanë mbikëqyrjen kufitare. Shtetet e zhvilluara kanë ndërtuar strukturë me kompetencë për ruajtjen e kufijve, ndoshta si detyrim i angazhimit në Bashkimin Evropian, por edhe si nevojë e ruajtjes nga migrimet ilegale, kontrabanda me migrantë, krimi i organizuar, kalimet ilegale, kontrabanda me mallra, tregtia e palejuar, e shumë dukuri tjera që lidhen me çështje kufitare.

Policitë kufitare kanë një zanafillë të hershme dhe shumica janë krijuar me themelimin e policisë së rregullt, por kryesisht gjatë shekullit XVIII dhe XIX janë modernizuar. Ato konsiderohen si agjenci kombëtare dhe


kanë për detyrë ruajtjen e kufirit kombëtar dhe zakonisht emërtohen si "Polici", "Trupa", "Rojë" ose edhe në disa emërtime si: "Rojet bregdetare", (në Gjermani dhe Ukrainë), por disa shtete me çështjet kufitare kanë njësitë e Xhandarmërisë të cilat si një trup konsiderohen dhe kompetencat e tyre shtrihen nga ato policore në drejtim të atyre ushtarake. Këto njësi kanë një mbikëqyrje jo vetëm nga ky mekanizëm, por të përfshirë edhe njësi tjera kufiri i nënshtrohet kontrollit tokësor, ujor dhe ajror. Njësitë kufitare janë të autorizuar me ligj për mbrojtjen e kufirit shtetëror dhe në kuadër të mbikëqyrjes kufitare sot janë disa njësi që patrullojnë duke filluar nga patrullime në këmbë përgjatë kufirit tokësor, patrulla me qen, patrulla mobile me automjete dhe njësi motorike duke përfshirë edhe ato dimërore, patrulla me barka në kufirin e kaltër (ujor) e deri te patrullimet ajrore me helikopter. Andaj, duke u bazuar në kompetencat ligjore dhe pajisjet teknike, sot policia kufitare konsiderohet si njësi e specializuar, duke i përfshirë trajnimin, uniformat, armët, pajisjet mobile, pajisjet logjistike etj. Në aspektin legjislativ me kufi nënkuptojmë vijën ndarëse të një territori dhe territorit tjetër ku aktivitete për kontroll mund të bëhen të përbashkëta dhe të sinkronizuara. Shumë shtete kanë ngritur qendra të përbashkëta koordinuese, ndërsa shumë institucione kanë rregulluar infrastrukturën ligjore dhe kanë nxjerrë rregullore për përdorim të përbashkët të logjistikës duke përfshirë edhe mjetet e përbashkëta të punës.

Në bazë të legjislacionit vendës Ligji Nr. 04/02-072 L i plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-214 neni 3, paragrafi 1.2 termi i kufirit shtetëror përcaktohet: Kufiri shtetëror - vija e cila e ndan territorin tokësor, ujor, nëntokësor, hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës me shtete fqinje, si dhe kufiri shtetëror në zonën e pikave të kalimit kufitar në aeroporte, nëpërmjet të cilave zhvillohet komunikacioni ndërshtetëror dhe ndërkombëtar; ndërsa po ky nen paragrafi 1.4 e përcakton edhe mbikëqyrjen kufitare si: Mbikëqyrje kufitare - mbikëqyrja e kufirit shtetëror ndërmjet pikave të kalimit kufitar dhe mbikëqyrja e pikave të kalimit kufitar jashtë orarit të caktuar të punës me qëllim që të pengohet shmangia e kontrollimit kufitar të personave. Pikërisht me këtë



ligj neni 3, paragrafi 1.7 parashihet edhe menaxhimi që nënkupton: Menaxhimi kufitar - aktivitetet dhe masat të cilat i ndërmarrin organet shtetërore të cilat janë të autorizuar për menaxhimin kufitar në pajtim me ligjet përkatëse në fuqi.

Duke u nisur nga obligimi institucional dhe ligjor, mekanizmi i policisë kufitare po luan një rol shumë të madh në mbikëqyrjen kufitare, andaj në këtë temë do të flasim më shumë për mbikëqyrjen kufitare duke nënkuptuar rolin e zyrtarëve kufitare që kryejnë detyrën e rojës kufitare. Pavarësisht emërtimeve të ndryshme, gjithnjë e më shumë po titullohen si Roje Kufitare duke i dhënë kuptimin dhe qëllimin e kryerjes së detyrave. Pikërisht këtu Ligji 04/L-072, KREU VI, përcakton mbikëqyrjen e kufirit shtetëror dhe Neni 35 nënkupton: Mbikëqyrja e kufirit kryhet me qëllim të parandalimit të kalimit ilegal të kufirit shtetëror, parandalimit të krimit tejkuftar dhe ndërmarrjes së masave kundër personave të cilët në mënyrë të paligjshme e kanë kaluar kufirin. Po ky ligj e përcakton edhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes kufitare dhe Neni 36 paragrafi 1 e përcakton si: Mbikëqyrja e kufirit kryhet me qëllim të parandalimit dhe dekurajimit të personave të cilët kanë për qëllim që ta evitojnë kontrollin kufitar në pikat e kalimit





kufitar. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton edhe pajisjet dhe metodën e punës të cilën mund ta përdorin zyrtarët patrullues për mbikëqyrje kufitare i cili thotë: gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së kufirit zyrtarët policorë kufitarë përdorin aparate statike ose mobile. Ndërsa Neni 37 e përcakton se: Mbikëqyrja e kufirit kryhet nga ana e zyrtarëve policorë kufitarë, numri i të cilëve dhe metodat e veprimit janë të përshtatura me rreziqet dhe kërcënimet ekzistuese. Gjithashtu Neni 38 duke u bazuar në paragrafët e mëposhtëm përcakton se: paragrafi 1. Mbikëqyrja e kufirit kryhet me përdorimin e njërive policore statike dhe mobile nëpërmjet patrullimit ose vendosjes në vende të cilat konsiderohen si kalime ilegale, me qëllim të zbulimit dhe pengimit të personave të cilët në mënyrë të paligjshme e kalojnë kufirin shtetëror. Paragrafi 2 përcakton se: Mbikëqyrja e kufirit mund të kryhet edhe me mjete teknike, duke përfshirë edhe mjetet elektronike, ndërsa në paragrafin 3 detajohet: Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së kufirit, policia kufitare është e autorizuar që të shfrytëzojë qen kufiri dhe të vendosë pengesa me të cilat pamundësohet kalimi ilegal i kufirit shtetëror.

Por, policia kufitare jo vetëm që është e autorizuar të ushtrojë kontroll në kufijtë shtetërorë por në bazë të ligjit ajo mund të shtrijë veprimtarinë e saj edhe brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe pikërisht këtu është përcaktuar të KREUN VIII Masat e policisë brenda shtetit, Neni 46 paragrafi 1. Në përputhje me këtë ligj, aktivitetet për kontrollin kufitar mund të kryhen në mbarë Republikën e Kosovës. Me qëllim të pengimit të trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandës së emigrantëve, kalimeve të paligjshme të kufirit dhe për të siguruar kontrollin e të huajve, zyrtarët policorë kufitarë autorizohen të: 1.1 kontrollojnë dhe zbatojnë masa adekuate me qëllim të zbulimit të hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm të shtetasve

dhe të personave të huaj në Republikën e Kosovës; dhe 1.2. kontrollojnë personat, sendet dhe automjetet jashtë zonave të kalimit kufitar.

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDERKOMBËTAR

Ashtu siç e cekëm edhe më lart policia kufitare bashkëpunon ngushtë me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, duke vepruar në përputhshmëri me legjislacionin e shteteve respektive dhe gjithnjë e më shumë janë shtuar aktivitetet e përbashkëta, duke filluar nga patrullimet e sinkronizuara, hetimin e krimeve ndërkufitare, parandalimin e kontrabandës, kalimeve ilegale, zbulimin e narkotikëve dhe arrestimin e personave të kërkuar. Të gjitha këto përveç krijimit të marrëveshjeve me secilin institucion kombëtar dhe ndërkombëtar, janë të bazuara në KREUN IX i Ligjit për Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Bashkëpunimin ndërmjet organeve shtetërore që kanë kompetenca në menaxhimin kufitar. Pikërisht Neni 47 paragrafi 1 thotë: Bashkëpunimi i organeve shtetërore në fushën e menaxhimit kufitar në ushtrimin e kontrollit kufitar, ministria bashkëpunon me organet tjera shtetërore që kanë kompetenca në menaxhimin kufitar në pajtim me ligj. 2. Bashkëpunimi nga paragrafi 1. i këtij neni realizohet ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës si dhe organeve tjera shtetërore që kanë kompetenca në menaxhimin kufitar. 3. Organet shtetërore nga paragrafi 2. i këtij neni bashkëpunojnë me qëllim të: 3.1. mundësimit të qarkullimit më të shpejtë të personave, mallrave dhe mjeteve transportuese në pikat e kalimit kufitar: 3. 2. pengimit dhe zbulimit të krimit ndërkufitar, mbledhjes, analizës dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informatave lidhur me menaxhimin kufitar;

dhe 3.3. realizimit të formave tjera të bashkëpunimit në pajtim me kompetencat e organeve shtetërore të përcaktuara me ligj. Ndërsa Neni 48 tregon për mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet organeve shtetërore në kufirin shtetëror dhe paragrafi 1. Organet shtetërore të përfshira në menaxhimin kufitar duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën dhe duhet të bashkëpunojnë ngushtë dhe në vazhdimësi me qëllim të realizimit sa më efikas dhe efektiv të kontrollit kufitar. 2. Bashkëpunimi nga paragrafi 1. i këtij neni realizohet përmes Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

Por, me këtë ligj janë të rregulluara edhe bashkëpunimet e organeve të huaja të sigurisë ose organet ndërkombëtare. Pavarësisht se deri më tani KFOR-i dhe organizatat tjera të mbështetura në Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian i kanë ofruar mbështetjet policisë kufitare dhe organeve të sigurisë në këtë ligj. Në Nenin 52 është përcaktuar edhe bashkëpunimi me organet e huaja të sigurisë ku thuhet: Ministria në pajtim me marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunon me organet e huaja të sigurisë në kryerjen e kontrollit kufitar. Ndërsa Neni 53 përcakton edhe oficerët për ndërlidhje ku është përcaktuar: Ministria në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare mund të dërgojë jashtë vendit oficerët për ndërlidhje, për kryerjen e punëve të bashkëpunimit policor ndërkombëtar, si dhe u përcakton detyra konkrete dhe autorizime. Sigurisht se autorizimet ligjore dhe udhëzimet administrative së bashku me marrëveshjet e nënshkruara me shtetet fqinje dhe mekanizmat ndërkombëtarë i japin një rol dhe detyrë të veçantë policisë kufitare duke e bërë një faktor domethënës në krijimin dhe ndërtimin e shtetit me kufij të kontrolluar dhe të sigurt.

Përgatiti: Toger Shaban OSMANOLLAJ



POLICIA E KOSOVËS KA FESTU

Me një ceremoni solemne që është mbajtur në sallën 1 Tetori në Prishtinë me datën 6.9.2014 është kremtuar 15 vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës nisi rrugëtimin e saj 15 vjet më parë duke u transformuar nga gjenerata e parë prej 176 kandidatëve policorë në shtator të vitit 1999, në një organizatë policore moderne, e krijuar sipas praktikave më të mira të policive ndërkombëtare për zbatimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Në këtë ceremoni solemne kanë marrë pjesë krerët më të lartë të vendit, duke filluar nga presidentja e Republikës së

Kosovës Atifete Jahjaga, ministri i Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi, ministra dhe përfaqësues të lartë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Nikoqiri i këtij eventi z. Shpend Maxhuni, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, pas përshëndetjes dhe mirëseardhjes që u ka dëshiruar të pranishmëve në fjalën e tij, ka thënë se gjatë rrugëtimit 15 vjeçar, Policia e Kosovës është përcjellë me shumë sfida por sipas tij, falë punës së palodhshme, profesionalizimit dhe përkushtimit të lartë, Policia e Kosovës ka arritur që të ofrojë shërbime cilësore.

“Falë punës së palodhshme, profesion-

Policia e Kosovës me 6.9.2014 ka festuar një ceremoni solemne, ku u tha se sigurisë ka qenë dhe është njëri nga faktorët më të suksesshëm të vendit.

alizimit të lartë, përkushtimit dhe sakrificës së secilit pjesëtar të Policisë së Kosovës, kemi arritur të ofrojmë shërbime cilësore si nga aspekti i sigorisë së qytetarëve të vendit dhe jo vetëm kaq, sot Policia e Kosovës është faktor i sigorisë dhe stabilitetit të vendit në përgjithësi”, ka theksuar Maxhuni.

Presidentja e Kosovës znj. Atifete Jahjaga në fjalimin e saj ka thënë: “Policia e





15 VJETORIN E THEMELIT

15 vjetorin e themelimit, me gjatë kësaj kohe ky institucion i lëvruar institucionet më të besueshme dhe më të shprehura në Kosovë

Kosovës është ndërtuar me standardet më të larta profesionale, të gjithëpërfshirjes së komuniteteve, me numrin më të lartë të grave në të, duke u bërë institucioni më i afërt dhe më i prekshëm nga çdo kategori e shoqërisë.

Sipas Jahjagës, rendi dhe ligji janë prioritet për institucionet e Republikës së Kosovës, prandaj institucionet e sigurisë kanë dëshmuar se janë të afta dhe të përgatitura që të veprojnë kundër grupit të izoluar të njerëzve të manipuluar, të rreshtuar përkrah grupeve ekstremiste, që përbëjnë kërcënim jo vetëm për shoqërinë e shtetit tonë por edhe më gjerë.

"Kosova asnjëherë nuk do të lejojë rritjen e grupeve të tilla në tokën e saj dhe asnjëherë nuk do të lejojë që vlerat e saj si shoqëri, të ndërtuara me shekuj, të lëkundën dhe të rrezikohen. Institucionet e Kosovës do të veprojnë në parandalimin e secilit kërcënim, duke ndërtuar bazën e një shteti ku sundon



ligji dhe rendi dhe ku liria e qytetarëve të tij, e mishëruar në Kushtetutë, është vlera më e madhe e saj", ka thënë Jahjaga. Kurse, ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, ka përmendur disa suksese të Policisë së Kosovës për këtë vit. "Në mënyrë të suksesshme Policia e Kosovës ka kontribuar në zgjedhjet e 8 qershorit 2014 që në bashkërendim me institucionet ka hartuar dhe zbatuar planin për menaxhimin e këtyre zgjedhjeve dhe për të siguruar mbarëvajtjen e këtij procesi. Dhe kjo ka kontribuar që të ketë zgjedhje më kredibile dhe më mirë të organizuar ndonjëherë në Republikën e Kosovës.

Ky sukses dëshmon rolin që ka Policia e Kosovës gjatë proceseve zgjedhore dhe menaxhimi i tij profesional që ky institucion e bën ashtu siç edhe proceset e tjera. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në të gjitha format, ka mbetur prioriteti kryesor i Policisë së Kosovës. Efikasiteti në luftimin e grupeve të organizuara kriminale ka rezultuar në shkatërrimin e shumë objekteve, jo vetëm vendore por edhe ndërkombëtare", ka thënë Rexhepi. Për nder të këtij përvjetori, pasi që kishin kaluar të gjitha procedurat e testimit, me sukses janë graduar edhe zyrtarë policorë, me gradën major 17, me gradën kapiten 19, me gradën toger 43, ndërsa me gradën rreshter 333 zyrtarë policorë dhe janë ndarë mirënjohje dhe lëvdata për zyrtarë policorë të dalluar. Pavarësisht sfidave Policia e Kosovës është dhe do të jetë çdo ditë e më e gatshme të përmbushë misionin e saj drejt zbatimit të ligjit ashtu siç dëshirojmë ne dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Sot Policia e Kosovës numëron rreth 8698 zyrtarë policorë dhe 1133 personel civil.

Përgatiti: Brahim Sadriu

AKADEMIA NDËRKOMBËTARE E ZBATIMIT TË LIGJIT NË



Evendosur në një pjesë shumë të bukur të Budapestit, në një kompleks ndërtesash ku secila ndërtesë ka funksionin dhe detyrat e saj, me një arkitekturë të vjetër, ku që nga momenti i hyrjes në hapësira mund t'i vëshesh rregullat strikte të funksionimit dhe pa dyshim se kjo ndërthurje gërshton në vete punën dhe përkushtimin e kësaj qendre. E njohur për programe trajnuese shumë të avancuara ku ngërthehet formësimi profesional dhe intelektual dhe promovohet jeta e shëndetshme në të gjitha drejtimet, mjafton të theksohet që secili që ka pasur rastin të jetë pjesë e kësaj qendre akademike mund ta dijë se bëhet fjalë për Akademinë e Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar (ILEA - Budapest).

Akademia ndërkombëtare e zbatimit të Ligjit (ILEA) në Budapest u hap në prill 1995 e mbështetur nga agjencitë amerikane të zbatimit të ligjit, qeveritë e Evropës Perëndimore dhe Kanadaja dhe u formua si një mjet për të luftuar rritjen e krimit të organizuar transnacional. Shumë vjet më parë Shtetet e Bashkuara zhvilluan konceptin e Akademisë së Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar (ILEA) dhe në dhjetor 1994, presidenti i atëhershëm Klinton, presidenti Göncz dhe kryeministri hungarez Horn kishin arritur një marrëveshje që Hungaria do të presë që ILEA të jetë organizata e parë për zyrtarët e zbatimit të ligjit nga Evropa Qendrore dhe Shtetet e Pavarura e Re (NIS). Që nga krijimi me qindra apo mijëra zyrtarë, zbatues të ligjit nga shumë vende të Evropës dhe më gjerë kanë ndjekur trajnimet në këtë qendër ku kanë marrë dhe dhënë për të tjerët eksperiencat e tyre të punës gjithmonë në funksion të marrjes së njohurive dhe praktikave më të mira dhe krijimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit në mes të agjensioneve të zbatimit të ligjit; organizatave, policive të vendeve të ndryshme pjesëmarrëse gjithmonë në funksion të luftimit të krimit transnacional dhe transkuftar.

Falë mbështetjes së vazhdueshme që agjencitë amerikane të sigurisë por edhe të tjerat i kanë dhënë Policisë së Kosovës që nga viti 2008 edhe zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës kanë filluar të jenë pjesë e trajnimeve të kësaj akademie me renome botërore në fushën e trajnimeve për zbatuesit e Ligjit dhe deri më tani në trajnimet e kësaj qendre kanë marrë pjesë qindra zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës duke ndikuar



kështu fuqishëm në ngritjen e kapaciteteve profesionale të Policisë së Kosovës.

Duke dashur që të ndajë eksperiencën time me të gjithë lexuesit e revistës 'Mbrotjtësi' do të mundohem t'ju paraqes punën apo formën se si është i rregulluar trajnimi dhe puna në Qendrën ndërkombëtare të zbatimit të Ligjit (ILEA) Budapest.

Një nga qëllimet bazë të kësaj qendre përveç trajnimit dhe praktikës së modeleve më të avancuara të zbatimit të ligjit është edhe krijimi i lidhjeve të bashkëpunimit në mes të zyrtarëve policorë të vendeve të ndryshme. Në çdo grup të pjesëmarrësve ka zyrtarë policorë të dy ose më shumë vendeve e në grupin tonë kishte zyrtarë policorë të tri vendeve, Policisë së Kosovës, Policisë së Shqipërisë dhe zyrtarë nga shteti nikoqir Hungaria. Uniforma e pjesëmarrësve jo vetëm që krijonte lehtësira për pjesëmarrësit pasi që ata e kishin të zgjidhur çështjen e veshjes e cila ishte shumë komode dhe padyshim krijonte barazi tek të gjithë



BUDAPEST - QENDËR ME VLERA TË LARTA TRAJNUESE

pjesëmarrësit pa dallim pozite, grade apo vendi. Ligjëratat mbahen në një nga sallat e shumta të qendrës, sallë shumë moderne me pajisjeje standarde ku çdo gjë ishte perfekte deri në detaje që nga forma e uljes, ku kontakti me zyrtarët policorë të vendeve tjera ishte i pashmangshëm e kjo ndikon direkt që në një kohë shumë të shkurtë të krijohen njohje të cilat prodhonin ekupe dhe raporte shoqërore dhe kolegjiale duke mos u dalluar se nga cili vend janë.

Ajo për të cilin ne ishim mbledhur në atë qendër akademik ishte trajnimi dhe temat që trajtohen të cilat gjithmonë ishin të ndërthura teoria me shembuj konkretë ku pjesëmarrësit përfshiheshin në role të ndryshme padyshim që ndikon në ngritjen e nivelit profesional por edhe në të menduarit ndryshe dhe në mendim alternativ për gjëra që ne trajtojmë në punë.

Menaxhimi me burime njerëzore, stilet e menaxhimit dhe qasjet bashkëkohore dhe kreative ndaj stafit dhe varësve tani janë temat e parë të trajtuara mjeshtërisht nga trajnerët e kësaj qendre, të cilët na mundësoni që secili ta shoh veten se cilit stil të menaxherit i takon, të reflektojmë mbi sjelljet tona në raport me të tjerët si në punë dhe jashtë saj.

Hetimet dhe menaxhimi hetimor i rasteve të ndryshme ishin boshti kyç i temave që trajtohen në trajnim dhe bashkëpunimi në mes agjensioneve policore në nivel rajonal dhe më gjerë ishte vlera që promovohet në luftimin e veprave penale që janë më të përhapura në botë tani. Lufta e përbashkët kundër 'Terrorizmi, ndaj të cilit nuk është imun asnjë vend'.

Hetimet e krimeve ekonomike dhe konfiskimet e aseteve të fituara në mënyrë të paligjshme dhe veprimtari kriminale,

duke përmendur vazhdimisht thënien "përcjell paratë" duke promovuar filozofinë e punës së grupeve kriminale të cilat mund të shkatërrohen vetëm nëse u shkatërrohet baza materiale.

Luftimi i industrisë kriminale që sot po konsiderohet si shumë fitimprurës në botë, kontrabandim me migrantë, trafikimi me genie njerëzore luftimi i trafikimit të drogave dhe kontrabandës me armë duke elaboruar me shembuj praktikë se si është qasja e agjensioneve amerikane në luftimin e kësaj dukurie.

Bashkëpunimi ndërmjet agjensioneve të zbatimit të ligjit brenda vendit dhe më gjerë format më të shpejta të komunikimit dhe rrjetet e komunikimit të cilat mundësojnë në kohë reale që përmes shkëmbimit të informatave të kryhet hetimi dhe çorganizimi i grupeve kriminale dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme ishin kryefjala dhe kallëzuesi i secilës temë.

Përgjimet dhe vëzhgimet si forma të hetimeve të fshehta ku kishim një skenar të përgatitur shumë mirë dhe mjaft sfidues, si dhe shumë tema tjera që ndërlihdën direkt me hetimet që kryejnë agjencitë e zbatimit të ligjit. Për të trajtuar këto materiale trajnuese shumë të rëndësishme për zbatuesit e ligjit në këtë trajnim kanë qenë prezentë dhe kanë ligjruar një numër shumë i madh, thënë ndryshe një kontingjent instruktorësh dhe trajnerësh të dëshmuar në karrierën e tyre kryesisht nga SHBA-të por dhe ligjruar nga Hungaria, të cilët para të pranishmëve shfaqnin dijen dhe praktikën më të mira të punës pa asnjë përtesë dhe hezitim. Ligjërimi interaktiv, skenarët dhe shembuj praktikë ishin pa dyshim mundësi e mirë për të krahasuar dhe për të zgjidhur që ne në punën tonë

të aplikojmë atë që është më e mira dhe më e dobishmja. Reagimet në situata emergjente dhe shkathtësitë e gjuajtjes në raste ekstreme pa dyshim që ishin maja e ajsbergut në këtë trajnim që na vunë në situata shumë dinamike por edhe të kënaqshme.

JO vetëm jeta akademike ishte prezent në këtë qendër, promovimi i jetës së shëndetshme pa duhan dhe me aktivitete sportive është një nga vlerat që i jep shumë domethënie dhe kuptim kohës gjatë trajnimit në këtë qendër. Organizimi i aktiviteteve rekreative, si: p. sh. vrapimet në parkun 'Margareta' me qëllim që ai që del i pari fiton simbolin hungarez të Bograques (një enë e vjetër tradicionale) fuste në ndërdijen e secilit karakterin e garës, edhe pse ishim të vetëdijshëm se sporti ndikonte shumë mirë në shëndetin tonë dhe këto aktivitete ndikojnë në psikikën tonë, duke sjellë relaks dhe çlodhje.

Edhe vikendet ishin kryesisht të aranzhuara. Vizitat në qytetet, si: Vjenë, Vishegradi etj. gjatë vikendeve ishin shumë të mirëseardhura dhe domethënëse për pjesëmarrësit e trajnimeve, pasi që ato ndikojnë në njohjen e qyteteve dhe historisë së vetë vendit nikoqir.

Darkat nacionale të shteteve pjesëmarrëse do të lënë gjurmë të thella në memorien e secilit pjesëmarrës. Përgatitja për këto evente dhe ushqimi, muzika dhe prezantimi i vendit përmes klipeve televizive janë disa nga mundësitë që kanë pjesëmarrësit për prezantim. Darkat nacionale fillojnë me vendin nikoqir dhe sipas rendit alfabetik për vendet tjera. Kësaj radhe Kosova ishte e treta pas Hungarisë dhe Shqipërisë dhe ishte një emocion i veçantë kur në detaje çdo gjë kishte shijen dhe ngjyrën e Kosovës.

Edhe pse në fillim trajnimi dukej pak i gjatë por ditët vraponin aq shpejt sa për një moment u gjendëm në javën e fundit, ku secili prej nesh ishte i preokupuar duke u përgatitur për ceremoninë finale të diplomimit dhe duke përgatitur valixhen të cilën e kishim zbratur disa javë më parë.

Siç është edhe vetë emri me renome i kësaj akademie edhe ceremonia e diplomimit ishte e përgatitur deri në detaje. Protokoli në rregull, veshja solemne, eleganca, ishin krejt çka mund të thuhet për ceremoninë. Aty ishin të ftuar dhe prezentë përfaqësues nga Ambasada e Kosovës në Hungari dhe personalitete të secilit shtet pjesëmarrës. Të gjitha fjalët e mira për grupin dhe akademinë ishin të tepërta, pasi që kjo mbrëmje e vultoste vetvetiu finalizimin e suksesshëm.

Dhe vjen dita e përhëndetjes me njëri tjetrin dhe me akademinë, përfundon edhe trajnimi në çdo përhëndetje ishin fjalët "ishte vërtet kënaqësi që u njohëm, jemi në kontakt".

Përgatiti: Brahim Sadriu



DELIKUENCA

Shkolla! Një fjalë shumë e dashur dhe ëndërr për çdo fëmijë. Shkolla, institucioni ku fuqizon, edukon dhe zhvillon fëmijët tanë, shpeshherë mund të kujtohet nga fëmijët si vendi ku ata kanë kaluar një "jetë" kushtimisht të themi me plotë gëzim, përvoja të mira dhe dëfrim me bashkëmoshatarët. Por, këtë mendim nuk e kanë edhe nxënësit e tjerë, ku ëndrra për shkollën nuk është ajo të cilën e kanë ëndërruar! Jo rrallëherë ndodh që, nga shumë nxënës, shkolla të kujtohet si vendi në të cilin ata kanë qenë subjekt i përbuzjes, nënvlerësimit, talljes e ndonjëherë edhe kanë përjetuar dhunë të tmerrshme psiko-fizike. Krijimi i një mjedisi të sigurt për nxënësit pa frikën nga sjelljet e dhunshme dhe jo shoqërore, është një sfidë relativisht e madhe për shoqërinë dhe para se gjithash një kusht elementar për ngritjen sigurisë dhe cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës. Në kohën e fundit, jemi dëshmitarë të shfaqjes së disa sjelljeve të dhunshme të formave të ndryshme, në shoqërinë tonë kosovare. Një perceptim i përbashkët është shfaqur, ku mendohet se dhuna është bërë më e përhapur dhe e theksuar në shoqërinë tonë, duke përfshirë edhe institucionet e edukimit para universitar të Republikës së Kosovës. Institucioni i edukimit para universitar është një hapësirë shoqërore e organizuar dhe e dizajnuar për të edukuar dhe arsimuar nxënësit. Është e pamundur që nxënësit të marrin dije të mirëfilltë nëse ata kanë frikë për sigurinë e tyre personale.

Përcjellja dhe ngritja e vetëdijes së nxënësve rreth delikuençës nuk është vetëm një detyrë e punës së mësuesve, arsimtarëve dhe profesorëve por, para se gjithash është detyrë primare e prindërve për edukimin dhe udhëzimin e fëmijëve të tyre për të praktikuar metoda jo të dhunshme gjatë komunikimit dhe zgjidhjes së problemeve. Bashkërisht, ata japin kontribut kyç për zhvillimin emotiv të nxënësve dhe luajnë rolin kryesor në zhvillimin shoqëror. Në mënyrë që të gjithë ta kuptojmë më mirë se çka do të thotë "delikuenca", do të mundohemi që ta thjeshtëzojmë dhe sqarojmë më hollësisht.

Me fjalën delikuenca kuptojmë atë dukuri psikike e cila manifestohet me mosrespektimin e normave morale dhe juridike. Delikuenca është një lloj sjelljeje



në kundërshtim me normat e caktuara shoqërore.

Ndërkaq, delikuent quhet ai individ i cili me veprimet e veta jo vetëm që shkel normat e mjedisit, por edhe cenon të drejtat dhe liritë e tjetrit dhe bie direkt në konflikt me të tjerët.

Në përqindje më të madhe në delikuenca përfshihen fëmijë deri në fazën e pubertetit dhe të adoleshencës, të moshës 13-18 vjeçe, të cilët bëjnë vepra të palejuara-delikte. Individët e tillë në mjedisin tonë zakonisht janë persona që në fillim nisin të ikin nga shkolla, nga shtëpia, merren me vjedhje të ndryshme, gënjejnë, ndërsa më vonë një përqindje e tyre përdorin alkool, ushtrojnë sjellje të dhunshme ndaj bashkëmoshatarëve dhe më vonë fillojnë edhe me përdorimin e drogës.

Hulumtimet e gjithmbarshme botëroretregojnë se, individë që bëjnë delikte të ndryshme, nuk lindin si të tillë. Në formimin personalitetit dhe kulturës së sjelljes së të miturit zakonisht ndikon familja. Mirëpo, ky ndikim mund të jetë edhe negativ, i cili mundëson ndërtimin e një karakteri konfliktuoz tek i mituri, kjo vije në shprehje sidomos në raportet jo të shëndosha me të miturin, posaçërisht nga prindërit kur njëri prej tyre është i sëmurë, alkoolist, i pamoralshëm, ushtron dhunë në sistematike në familje etj., gjendja e rëndë ekonomike, mjedisi i papërshtatshëm shoqëror etj. Sjellja njerëzore është një fushë mjaft e ndërlikuar për ta shpjeguar veçanërisht kur të flasim për delikuenca e të miturve. Do të përmendim disa shkaktarë kryesorë, të cilët ndikojnë direkt në ndryshimin e karakterit tek i mituri dhe kontribuojnë në ushtrimin e sjelljeve të dhunshme apo delikuençës.

Sipas përvojës së deritashme si dhe duke u mbështetur në teori të ndryshme analitike dhe shkencore, mund të arrijmë tek një përfundim se shkaktarët dhe format më të shpeshta të cilat i nxisin të rinjtë të bien në delikuenca janë kryesisht:

1. Tranzicioni -faza e ndryshimeve – puberteti (ndjenja se "tash jam i pavarur");
 2. Familja (sjelljet e dhunshme sistematike nga ana e prindërve, disiplina e rreptë, nivel i ulët i mbikëqyrjes së të miturit, refuzimi i vazhdueshëm i iniciativave dhe kreativitetit të të miturit nga ana prindërore etj.),
 3. Kushtet socio-ekonomike (varfëria, pasuria);
 4. Mungesa e kreativitetit dhe rekreacionit sportive nga ana e të miturve;
 5. Izolimi apo refuzimi nga grupi (largimi nga shoqëria, përbuzja, përqeshja) etj.
- Mirëpo, është me rëndësi të ceket se, sjellja delikuede nuk shfaqet menjëherë, aty-për-aty, por pas një akumulimi të një historie apo të kaluarë jo paqësore, qoftë në gjirin familjar apo në shoqëri apo edhe në jetën e përditshme nga trajtimi i të tjerëve. Sjelljet tona varen nga ndjenjat dhe mendimet tona të akumuluar nga përvoja jetësore!
- Më pas, delikuenca e të miturve karakterizohet edhe me ikje nga orët e mësimi pa ndonjë arsye dhe shpesh kemi rastë kur këta nxënës kanë qenë delikuentë me sjelljet e tyre ndaj të tjerëve (rrahje, kërcënim, rrahje grupore, detyrim etj.).
- Për më tepër, delikuenca e të miturve në faza të mëvonshme karakterizohet me



E TË MITURVE

rritje të vazhdueshme të negativitetit dhe formave të ndryshme të paraqitjes dhe se rrezikshmëria shoqërore e saj konsiston në aktivitete të ngjashme me kriminalitetin e të rriturve, me disa përjashtime, pra delikuentët e mitur marrin pjesë në kriminalitetin kundër pasurisë, në kriminalitetin kundër sigurisë në trafik, në krime kundër jetës dhe trupit dhe në delikte seksuale.

Kodi i drejtësisë për të mitur parasheh një numër të madh të masave të cilat mund t'u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale, këto lloje të masave janë:

- Masat e Diversitetit:

- Pajtimi në mes kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, ku përfshihet edhe kërkim falje, - Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij,

- Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar, në bazë të marrëveshjes së ndërsjellët ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit ligjor,

- Vijimi i rregullt në shkollë,

- Pranimi i punësimit apo aftësisimit pa pagesë në një profesion adekuat me aftësitë e tij,

- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme, në pajtim me aftësitë e kryerësit e mitur,

- Edukimi në rregullat në trafik, dhe

- Këshillim psikologjik.

- Masat edukative:

- Masat disiplinore ku bën pjesë qortimi gjyqësor dhe dërgimi në qendër disiplinore,

- Masat e mbikëqyrjes së shtuar janë: mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë,

- Masat institucionale edukative janë, dërgimi i të miturit në institucion edukues, dërgimi i të miturit në institucion edukativo-korrektues dhe dërgimi i kryerësit të mitur në institucione të kujdesit të posaçëm.

Një numër relativisht i madh i rasteve të dhunës ndaj nxënësve mbetet i fshehur apo nuk raportohet edhe pse kjo dhunë është prezente. Nxënësit kanë frikë apo ngurrojnë ta paraqesin apo raportojnë dhunën në shkollë, për shkak se frikësohen ose për shkak të lidhjes që kanë me ushtruesin e dhunës apo, dhunën aspak nuk e konsiderojnë si diçka të gabueshme ose të jashtëzakonshme, por e shohin si ndëshkim të arsyeshëm për

veprimet ose mosveprimet e tyre.

Nxënës të cilët janë viktimë e dhunës në shkollë mund të ndjehen "fajtorë" dhe të krijojnë perceptimin dhe besimin se e meritojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre. Në të kaluarën, por edhe në ditët e sotme, në shoqëri dhe tradita të ndryshme, ndëshkimi fizik ka qenë dhe sipas situatës në terren ende mbetet njëra nga mënyrat për imponimin e "zgjidhjeve", disiplinimin dhe "edukimin" e nxënësve apo nënshtrimin e tyre sipas rregullave të një grupi të caktuar nxënësish apo individësh në hapësirat shkollore.

Nxënësit nuk kanë të drejtë të lëndojë nxënësit tjerë duke i goditur ata, rrahur, duke i etiketuar me emra të ndryshëm nënçmues, duke iu dërguar atyre mesazhe të ndryshme kërcënuese, duke përhapur thashetheme për nxënësit e caktuar dhe zbehur kredibilitetin moral dhe etik të tyre apo duke bërë veprime të ngjashme, me të cilat do të ndikojë negativisht në disponimin dhe cenimin e të mirave që ofron jeta në përgjithësi. Është shumë me rëndësi që së bashku, të bëjmë diçka për parandalimin e këtij fenomene. Para së gjithash kjo vlen për nxënësit. Nganjëherë dhuna në shkollë mund të largohet shumë shpejt nëse raportohet me kohë, mirëpo duke bërë asgjë në këtë drejtim, kjo mund të vazhdojë derisa të kemi me të vërtetë pasojë fatale për nxënësit. Ky nxënës mund të jetë shoku apo shoqja juaj apo edhe vetë Ju!

Nëse kjo dhunë iu ndodh juve, mos mendoni që Ju duhet të ndryshoni dhe t'i përshtateni rregullave të dikujt, mirëpo, ai i cili duhet të ndryshojë dhe të përshtatet me rregullat e përgjithshme është me të vërtetë ushtruesi

i dhunës.

Disa nga simptomat e mundshme përmes të cilave ne si nxënës kemi mundësi të identifikojmë se shoku apo shoqja jonë po përjeton sjellje të dhunshme janë:

- Përtesa për të shkuar në shkollë;
- Të pafuqishëm;
- I padisponuar në shtëpi dhe në shkollë;
- I tërhequr nga shoqëria dhe bisedat e bashkëmoshatarëve;
- Pretendimi se është me grip (kjo kalon në shprehje);
- Sjellje agresive verbale me shokët/shoqet apo edhe me prindërit në shtëpi;
- Higjienë jo e mirë (flokët e pakrehura, të paprera, thonjtë e paprerë, rrobat e ndyra);
- Mungesa e rezultateve në shkollë.

ÇKA TË BËJMË NËSE NE JEMI SUBJEKT I SJELLJEVE TË DHUNSHME:

- Mos reago me të njëjtën sjellje me ushtruesin e dhunës, POR largohu sa me shpejt të jetë e mundur nga ai vend;
- Largohu dhe mbaj mend se nuk është faji yt;
- Mos keni frikë, gjithsesi, tregoji prindit, mësuesit, ndonjë të rrituri që ti ke besim në të apo zyrtarit policor se çka ju ka ndodhur;
- Mundohu të qëndrosh në shoqëri sikur juve nuk iu lë shumë përshtypje sjellja joshqërore.

ÇKA TË BËJMË NE SI NXËNËS NESE JEMI DËSHMITARË TË USHTRIMIT TË DHUNËS NDAJ NJË NXËNËSI TJETËR?

Fillimisht ju duhet ta kuptoni se sjelljet e dhunshme, përqeshjet, nënçmimet deri tek dhuna fizike nuk janë të mira për askënd, andaj nëse e shihni ndokënd që po përjeton këto sjellje:

- Përkrahe – edhe nëse nuk është nga klasa jote;
- Mos iu bashko grupit i cili ushtron sjelljet e dhunshme;
- Menjëherë trego se çka ke parë;
- Përpiku ta afrosh personin ndaj të cilit është ushtruar sjellje e dhunshme.

Bashkërisht t'i parandalojmë sjelljet e dhunshme në shkollë duke raportuar që në fazat e hershme të tyre!
THUAJ NDAL DHUNËS!

Përgatiti: Mentor CAKOLLI



RËNDËSIA E IDENTIFIKIMIT TË DOKUMENTEVE TË FALSIFIKUARA, TRAJNIMI PËR IDENTIFIKIMIN E ORIGINALITETIT TË TYRE

Identifikimi dhe legjitimimi i personave ka histori të hershme, njerëzit janë legjitimuar dhe identifikuar nëpër kohë të ndryshme. Në kohën e formimit dhe para formimit të SHBA-ve, personi i skllavëruar ka fituar një copë letër e cila është quajtur dokument dhe ai dokument i fituar ka prezantuar lirinë e tij (pamje nga filmi 12 vjet skllav)

Shtetet në vazhdimësi kanë bërë përpjekje për të prodhuar dokumente zyrtare dhe bankënota të cilat nëpër periudhat kohore të kenë siguri, qëndrueshmëri të lartë të përdorimit dhe të jenë të mbrojtura nga ndërhyrjet në falsifikimin tyre, por kjo siguri shpesh është goditur nga persona dhe grupe të organizuara të cilët kanë bërë të pamundurën për falsifikimin dhe ndryshimin e tyre. Kjo ka shtuar përpjekjen që shtetet kanë bërë të pamundurën në mbrojtjen e dokumenteve dhe bankënotave dhe monedhave të tyre duke siguruar material të qëndrueshëm dhe masa të larta të sigurisë, duke ditur se grupe të organizuara apo individë për interesat e përfitimit në vazhdimësi kanë bërë përpjekje për falsifikimin e tyre. Organet të cilat janë marrë, në këtë rast shteti ka bërë përgatitjet që në çdo rast të plasojë tipare të larta të sigurisë për të mbrojtur dokumentin dhe bankënotat të cilat i ka vënë për qarkullim, të vetëdijshëm se edhe pas kësaj sigurie ekziston mundësia e falsifikimit, por vendosja e shumë tipareve të sigurisë ka bërë vështirësimin e falsifikimeve. Mbajtja e të dhënave në ruajtjen dhe identifikimin e tipareve të sigurisë paraqet hapin shumë të rëndësishëm në punën policore.

Në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri Policia e Kosovës ndjek një kurs i cili ka një rëndësi shumë të veçantë në përgatitjen e zyrtarëve policorë drejt avancimit me njohuritë e reja e sidomos njohja me dokumentet e falsifikuara. "Kjo është një sfidë për



Policët duke bërë identifikimin e NIV

të gjithë punonjësit, të cilët kanë përballë njohjen me dokumentet dhe mundësinë e identifikimit se cili është dokument legjitim (origjinal) dhe cili është dokument i falsifikuar", thotë toger Bahri Bylykbashi instruktor në AKSP. Ai më tej vazhdon se në akademi njoftohemi me njohuritë e reja me tiparet e sigurisë së dokumente dhe bankënotave se si ato punohen me material shumë të sigurt për qëndrueshmërinë e letres dhe cilat janë masat të cilat shtetet, si shembull:


Gjermania, SHBA-të, shtetet e Ballkanit, ato afrikane dhe aziatike, se cilat janë veprimet që kanë marrë për të siguruar dokumentet e tyre origjinale nga mundësitë që janë shumë të pranishme që këto dokumente të falsifikohen dhe të përdoren për qëllimet e emigrimit, të fshehjes së identitetit, veprimeve tjera kriminale etj. dhe në këtë mënyrë këto të dhëna të cilat ne i posedojmë i ligjërojmë me kujdes të shtuar dhe i përcjellim tek zyrtarët që ndjekin trajnimin në këtë fushë rreth

dokumente të falsifikuara, thekson toger Bylykbashi.

Nga prezantimi i identitetit, shfrytëzimi i tyre për nevoja personale, si lëvizja ndër kufi, dokumente, paraqesin bazën e të dhënave tona. Policia është ajo e cila duhet të përballlet me identifikimin e personit, legjitimitimin e tij dhe kontrollimin e automjetit dhe dokumentacionit përcjellës të automjetit dhe nga të gjitha këto të krijojë një bindje të plotë se dokumenti i cili gjendet në duart e zyrtarit policor të marrë përgjigje se a është dokument legjitim dhe a përputhen të dhënat e personit me moshën në fotografi dhe në prezantimin e tanishëm. Forma se si prezantohet personi i cili legjitimohet, tiparet e lëvizjes që ai bën dhe faktorë të tjerë, të gjitha këto japin mundësinë e një identifikimi të mirë, thekson toger Bylykbashi. Pas identifikimit me tiparet personale vazhdojmë me kontrollimin e tipareve të sigurisë, ku disa tipare mund të kontrollohen edhe gjatë një kontrole, pa pasur nevojë të përdoren pajisjet, si: retrovizori, drita ultra violet apo xhami zmadhues.

Ajo se çka konsiderohet e rëndësishme sipas toger Bylykbashit është se dokumentet duhet të kontrollohen me kujdes të shtuar dhe të kemi njohuri se cilat janë tiparet e sigurisë të cilat i ka vendosur shteti nga i cili është bërë prodhimi i dokumentit. Për të gjitha këto tipare nëse polici arrin të mbajë në mend gjërat elementare nga ky kurs, puna praktike do të jetë shumë e rëndësishme dhe me rezultate në terren. Kjo për faktin se çdo kontroll i dokumentit me detaje paraqet profesionalizmin tonë. Në AKSP në Vushtrri zyrtarët policorë pajisen me të gjitha të dhënat të cilat duhet t'i dinë në punën e tyre në terren dhe mbetet nga ana e tyre që njohuritë t'i zbatojnë në mundësitë më të mira, sepse vetëm kështu i bëjmë nder punës sonë dhe besimit, të cilin e kanë qytetarët tek ne si Polici e Kosovës.

Nga këto njohuri të trajnimit, zyrtarët policorë marrin njohuritë se si bëhen të gjitha ekzaminimet e dokumenteve të ndryshme dhe shteteve të ndryshme, kur policia ka kohë të mjaftueshme për të përdorur mjetet e nevojshme, si: pinceta, dritat ultra violet, zmadhues i ndriçuar, re-tra-shikuesi, mikroskopi,



Toger Bahri Bylykbashi, instruktor në AKSP në Vushtrri

mjeti i cili transmeton dritat në pozita të ndryshme. Me anë të këtyre mjeteve bëhet kontrollimi nga tipari i sigurisë së letrës e deri te printimi dhe të dhënat të cilat janë të vendosura në dokumente, thekson ndër të tjera toger Bylykbashi.

Vlerë të veçantë dokumentet paraqesin edhe me ligjet e aplikueshme në

Kosovë, si: Kodi Penal i Kosovës, i cili mbron dokumentet legjitime dhe aplikon sanksione për falsifikatorët e dokumenteve dhe falsifikatorët e monedhave. E tëra nga trajnimi mbetet zbatimi në terren.

Përgatiti: Mërgim Bekteshi



Pajisjet për verifikimin dhe ekzaminimin e dokumenteve

OPERACIONE

DISA NGA OPERACIONET E SUKSESSHME TË VITIT 2014 NG

POLICIA E KOSOVËS REALIZON NJË OPERACION TË GJERË POLICOR NË SHKALLË VENDI

Policia e Kosovës pas një pune operative-hetimore disamujore në bashkëpunim me Pokurorinë e Shtetit, me 11.08.2014 në orët e hershme të mëngjesit ka zhvilluar një operacion të gjerë në nivel të vendit për arrestimin e personave të dyshuar cilët kanë marrë pjesë në luftimet në Siri dhe Irak përkrah organizatave të shpallura terroriste (ISIS dhe Al-Nusra).

Ky operacion policor është ndërmarrë duke vlerësuar rrezikun dhe rëndësinë për sigurinë nacionale, mbrojtjen e rendit kushtetues, ruajtjen e rendit dhe ligjit si dhe në frymën e ruajtjes së respektimit të të drejtave të secilit person, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjatë realizimit të këtij operacioni policor janë bastisur rreth 60 (gjashtëdhjetë) lokacione, ku janë arrestuar 40 (dyzet) persona, nën dyshimin se kanë kryer vepra penale nga kapitulli "VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS" i Kodit Penal të Kosovës.

Ndërsa në cilësi të provave materiale janë konfiskuar materiale inkriminuese lidhur me veprat për të cilat dyshohen këta persona, duke përfshirë mjete eksplozive, armë dhe municion të kalibrave të ndryshëm si dhe dëshmi tjera që ndërlidhen me rastin.

POLICIA E KOSOVËS ARRESTON EDHE DY PERSONA TË DYSHUAR PËR VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Si rezultat i hetimeve disamujore, në ndërlidhje me rastin e arrestimit të katër (4) personave gjatë muajit qershor 2014 në Kaçanik për veprat e njëjta penale, me 14/8/2014 në orët e hershme të mëngjesit, Policia e Kosovës, sipas urdhrat nga gjyqtari i procedurës paraprake të EULEX-it, ka ndërmarrë një operacion për zbatimin e urdhër kontrollit në dy lokalitete në Gjilan dhe Skenderaj.

Ky operacion policor ka rezultuar me arrestimin e dy (2) personave të dyshuar, që dyshohet të jetë një ndër frymëzuesit kryesorë të xhihadit dhe i dyshuari tjetër nën dyshimin se të njëjtit kanë kryer veprat penale nga kapitulli "Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës":

- Rekrutim për terrorizëm, sipas nenit 139 të KPK-së,
- Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist, sipas nenit 143 të KPK-së,
- Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, sipas nenit 147 të KPK-së.



Gjatë zbatimit të urdhërkontrollit, te njëri nga të dyshuarit Z.Q. nuk ka qenë në shtëpinë e tij, por i njëjti është gjetur nga Policia e Kosovës, i fshehur në veturën e tij në një terren malor në afërsi të shtëpisë së tij ndërsa i dyshuari i dytë është gjetur në vendbanimin e tij.

Gjatë zbatimit të urdhërkontrolleve, janë sekuestruar edhe dëshmi materiale që ndërlidhen me veprat e lartcekura penale.

Personave të arrestuar me urdhër të prokurorit të Prokurorisë Speciale u është shqiptuar masa e ndalimit policor prej 48 orësh.

OPERACIONI KOKAINA

Në një operacion të përbashkët të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Shqipërisë të koduar "KOKAINA" shkatërrohet një grup kriminal dhe sekuestrohet sasi e konsiderueshme e drogës. Në vazhden e hetimeve të përbashkëta janë shkëmbyer informacione si dhe janë realizuar takime pune në mes të Prokurorisë Speciale dhe Policisë së Kosovës për t'i harmonizuar veprimet në terren dhe menjëherë është vendosur kontakti i drejtperdrejtë në mes të hetuesve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë. Si pjesë e operacionit policor hetuesit e Policisë së Kosovës kanë reaguar dhe kanë bastisur një shtëpi në rajonin e Pejës. Gjatë bastisjes së shtëpisë është gjetur një lokacion i improvizuar, si laborator në të cilin janë gjetur pajisje që shërbejnë për matje, përzirje dhe paketim të substancës narkotike. Në këtë lokacion në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe sekuestruar, 18 kg. e 235 gramë lëndë narkotike të llojit kokainë, 5 kg. e 955 prekursorë, 8 litra acid klorhidrik, 246 litra acetone, 7 litra hidro-kiselinë, pajisje laboratorike: (mikserë, sita, korita, ventilatorë, llampa, dorëza, peshore, 2 vetura, 1 shkopion, 1 revole me gas, 1 pushkë ajrore, 2 karikatorë me 18 fishekë 7.65mm, 1200 euro, 7040 lekë shqiptarë, 65 Franga CH, telefona celularë dhe prova tjera. Po ashtu në Shqipëri në kuadër të këtij operacioni si rezultat i hetimit të përbashkët dhe shkëmbimit të informacioneve janë arrestuar dy persona dhe janë konfiskuar 207 kg. e 360 gr.



kanabis sativa, 22 kg. e 323 gr. Heroinë, 2.8 gr. Kokainë, 22 bidona nga 25 litra me aceton, 6 armë zjarri, 929 fishekë, 143 000 euro, 3 automjete, 25 telefona celularë. Dhe prova të tjera relevante për rastin.

ARRESTOHET NJË GRUP KRIMINAL NËN DYSHIMIN E BAZUAR PËR 'RRËMBIM', 'DETYRIM' DHE 'SHANTAZH'

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, përmes rrugëve operative-hetimore ka siguruar informacionin se në Ferizaj ishte duke ndodhur një vepër e rëndë penale e 'rrëmbimit', 'detyrimit' dhe 'shantazhit'. Në bazë të informacioneve të pranura Policia ka ndërmarrë veprimet proaktive hetimore, me ç'rast janë identifikuar të dyshuarit e mundshëm si dhe mënyra e planifikimit të veprës. Në bazë të informacioneve të dyshuarit e kishin rrëmbyer viktimën, të cilën e kishin keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht. Nga viktimja të dyshuarit kishin kërkuar t'ua sillte një shumë parash prej 10.000 (dhjetë mijë euro) me kusht që atë ta linin të lirë. Viktimja kishte pranuar një gjë të tillë. Hetuesit policorë ishin në gjurmë të kësaj vepre dhe në koordinim me prokurorin e shtetit dhe gjykatën, me qëllim të materializimit të provave të nevojshme për këtë vepër, me datën 17.6.2014 arritën të realizojnë operacionin duke i kapur të dyshuarit në flagrancë. Të gjitha veprimet policore lidhur me këtë rast janë kryer nën autorizimin e prokurorit përkatës dhe të dyshuarit janë dërguar në mbajtje policore për vazhdim të procedurës.

Arrestohet një person i dyshuar për 'trafikim me njerëz' dhe identifikohet një viktimë e shfrytëzuar për 'lypësi të detyruar'

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, njësi në Prishtinë, me 18.6.2014 në kuadër të implementimit të planit operativ policor "Identifikimi i lëmshëkërkuesve" si viktimja të mundshme të 'trafikimit me njerëz' ka arrestuar një person me dyshimin e bazuar se ka kryer veprën penale "trafikim me njerëz". Gjatë këtij plani policor zyrtarët policorë nga kjo njësi kanë identifikuar një viktimë

potenciale të 'trafikimit me njerëz', për të cilën dyshohet se është shfrytëzuar për 'lypësi të detyruar'. Lidhur me rastin është identifikuar dhe është arrestuar personi i dyshuar mashkull shtetas i Shqipërisë, i cili është arrestuar dhe me vendim të prokurorit përkatës është dërguar në mbajtje për 48 orë për të vazhduar me procedurat tjera hetimore. Viktimja e rastit është strehuar në 'Shtëpinë e sigurt' për viktimat e trafikimit.

ARRESTOHEN TRE PERSONA NËN DYSHIMIN E BAZUAR PËR 'KONTRABANDIM TË MIGRANTËVE' DHE 'FALSIFIKIM TË DOKUMENTEVE'

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, pas hetimeve të kryera lidhur me veprimtarinë kriminale të një grupi, që merrej me kontrabandim të migrantëve dhe falsifikim të dokumenteve, në rajonin e Pejës dhe të Prizrenit, ka ndërmarrë operacionin e koduar me emrin "RRUGA" dhe është arrestuar ky grup të dyshuarish të cilët në vazhdimësi kryenin veprat penale të kontrabandimit të migrantëve dhe falsifikonin dokumente, duke përfutur mjete financiare në mënyrë të kundërligjshme.

Gjatë këtij operacioni janë sekuestruar si prova materiale: një laptop, një shtëpizë kompjuteri, tre telefona celularë, dokumente që dyshohen si të falsifikuara, një armë gjuetie e kalibrit 12 mm dhe 12 fishekë të të njëjtës armë, personat e dyshuar janë dërguar në mbajtje policore për vazhdim të procedurës të mëtejme hetimore.

ARRESTOHEN TRE PERSONA TË DYSHUAR PËR 'TERRORIZËM'

Si rezultat i hetimeve, Drejtoria Kundër Terrorizmit, nën mbikëqyrjen e Prokurorisë Speciale të Kosovës, me 26.6.2014, 06:00, ka realizuar një operacion policor i cili ndërlidhet me hetimet ndaj disa personave të dyshuar për përfshirje në vepra penale 'Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist', 'Rekrutim për terrorizëm' dhe "Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik". Operacioni policor i koduar "Goditja", i realizuar nga Drejtoria Kundër Terrorizmit, është mbështetur edhe nga njësitet tjera policore të Divizionit të Njësiteve Speciale si dhe njësiteve tjera relevante, i cili ka rezultuar me arrestimin e tre persona të dyshuar. Në vazhdim të hetimeve, sipas urdhërësës së gjyqtarit të EULEX-it të procedurës paraprake nga Gjykata Themelore në Ferizaj, është realizuar bastisje në dy lokalitete dhe gjatë bastisjes në cilësi të provave materiale janë sekuestruar pajisje elektronike (kompjuterë, Lap-Top, SIM kartela, revole me gaz, material propagandistik, uniforma ushtarake, pasaporta, dylbi. Me vendim të prokurorit personave të dyshuar u është caktuar masa e ndalimit prej 48 orësh për të vazhduar me procedurat tjera hetimore.





ARRESTOHEN PESË PERSONA TË DYSHUAR PËR 'TRAFIKIM ME SUBSTANCA NARKOTIKE' DHE KONFISKOHEN MBI 30 KILOGRAMË SUBSTANCË NARKOTIKE

Me 26.6.2014, në rrugën magjistrale Drenas-Komoran, Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë, ka realizuar një operacion policor, me ç'rast ka arrestuar tre persona të dyshuar me dyshimin e bazuar se kanë kryer veprat penale 'blerja, posedimi, shitja e paautorizuar e substancave narkotike' dhe 'mbajtja në kontroll dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe municioneve'. Operacioni policor ka filluar derisa zyrtarët policorë në fshatin Zabel i Ultë kanë ndaluar veturën Jeep Grand Cherokee ngjyrë e hirit, të cilën e ngjiste e dyshuara Z. K. dhe pas kërkesës së zyrtarëve policorë që të hapte bagazhit e veturës për kontroll i dyshuari ka tentuar të ikë nga vendi i ngjarjes por falë reagimit të shpejtë të zyrtarëve policorë ai është kapur dhe është vënë nën kontroll dhe në prezencë të tij gjatë kontrollit të veturës në bagazh janë gjetur 10 paketime të mbushura me substancë narkotike që dyshohet të jetë e llojit marihuanë, të cilat ishin të vendosura në një çantë ngjyrë të zezë e që pas matjes rezultoi të jenë me peshë prej 10,714 gramë (dhjetë kilogramë e shtatëqind e katërmëdhjetë). Pas konsultimit të prokurorit përkatës dhe urdhërës së gjyqarit të procedurës paraprake në orën 07:30 në fshatin Çikatovë e re ka vazhduar operacioni me kontrollimin e shtëpisë, pronë e të dyshuarit të dytë A. Gj. si i dyshuar i përfshirë në këtë rast, ku gjatë kontrollit në shtëpinë e tij është gjetur një armë pa leje e llojit revole ngjyrë e zezë e modelit Armenius dhe 40 fishekë të kalibrit 38 mm dhe në objektet përcjellëse është konfiskuar edhe një armë gjuetie e llojit Altay Magnum, 19 fishekë të kalibrit 12 mm me leje përkatëse për mbajtje në emër të prindit të të dyshuarit por me afat të skaduar të cilat janë konfiskuar nga njësitet e Krim-teknikës në cilësi të provave materiale. Operacioni policor ka vazhduar në lokacionin e tretë në fshatin Baicë, komuna e Drenasit, dhe në shtëpinë e të dyshuarit të tretë B. Gj. Gjatë bastisjes në shtëpinë e tij janë gjetur dhe konfiskuar 20 paketime të mbushura me substancë narkotike të llojit marihuanë të cilat ishin të vendosura në një çantë ngjyrë të zezë e që pas matjes ka rezultuar të jenë me peshë prej 21,147 gramë (njëzet e një kilogramë e njëqind e dyzet e shtatë). Të gjitha veprimet policore lidhur me këtë rast janë kryer nën autorizim të prokurorit përkatës dhe të dyshuarit janë dërguar në mbajtje për të vazhduar me procedurat tjera hetimore.

ARRESTOHET NJË PERSON PËR VEPRËN PENALE 'MARRJE E RYSHFETIT'

Me 16.6.2014, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, njësia në Ferizaj, pas një pune

hetimore ka arrestuar në flagrancë të dyshuarin mashkull shqiptar kosovar, punonjës në spitalin rajonal të Ferizajt, nën dyshim se ka kryer veprat penale 'marrje e ryshfetit' dhe 'keqpërdorim i detyrës dhe autoritetit zyrtar'. Pas arrestimit dhe gjatë bastisjes tek i dyshuari gjatë kontrollimit janë gjetur dy kartëmonedha 2x50=100 euro, të cilat janë konfiskuar në cilësi të provës materiale. Të gjitha veprimet policore lidhur me këtë rast janë kryer në konsultim me prokurorin përkatës dhe ndaj të dyshuarit është caktuar masa e ndalimit për 48 orë.

ARRESTOHEN TRE PERSONA TË DYSHUAR PËR 'KULTIVIM TË SUBSTANCAVE NARKOTIKE'

Pas hetimeve rreth tremujore, Drejtoria për Hetimin Trafikimit me Narkotikë me 10.7.2014, rreth orës 19:30, ka realizuar një operacion policor, me ç'rast ka arrestuar tre persona të dyshuar, me dyshimin e bazuar se të njëjtët kanë kryer veprën penale 'kultivim të substancave narkotike' dhe ka asgjësuar 1448 bimë kanabis sativa. Hetuesit policorë përmes rrugëve operative kishin pranuar informacione se këto bimë kishin qenë të mbjella katër parcela në një fshat në rrethinë të Podujevës. Të gjitha veprimet policore lidhur me këtë rast janë kryer nën autorizim të prokurorit përkatës dhe të dyshuarve u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë, për të vazhduar me procedurat tjera hetimore.

ARRESTOHEN TRE PERSONA TË DYSHUAR PËR 'KONTRABANDIM ME MIGRANTË'

Njesiti i Hetimeve të Departamentit të Policisë Kufitare, të asistuar nga njësitë tjera policore, ka realizuar një operacion policor, me ç'rast kanë arrestuar tre persona të dyshuar me dyshimin e bazuar se të njëjtët kanë kryer veprat penale 'kontrabandim me migrantë', 'falsifikim të dokumenteve' dhe 'posedim i paautorizuar i armëve dhe municionit' si dhe ka konfiskuar një numër të konsiderueshëm të dokumenteve dhe gjësendeve tjera në cilësi të provave materiale.

Operacioni policor ka filluar duke kryer bastisje në pesë lokacione të ndryshme të regjionit të Prizrenit. Gjatë bastisjes janë gjetur dhe konfiskuar në cilësi të provave mijëra dokumente të ndryshme, si: pasaporta, letërnjoftime, certifikata të lindjes, të shtetësisë, forma të ndryshme të aplikimeve për nxjerrjen e dokumenteve (serbe, bullgare, shqiptare) barna të ndryshme që dyshohet se janë të kontrabanduara, një revole, municione të gjuetisë, një thikë etj. Personat e dyshuar, tashmë të arrestuar nga policia, dyshohet se në mënyrë të organizuar dhe në bashkëpunim, me qëllim të përfitimit material, përmes rrugëve ilegale apo me dokumente të falsifikuara, kanë dërguar apo kanë tentuar të dërgojnë shtetasit kosovarë drejt vendeve të Bashkimit Evropian, ku shumë prej tyre janë viktimizuar, qoftë fizikisht qoftë materialisht.



PORTRET


Të nderuar lexues, në rubrikën 'portret' të revistës sonë kësaj radhe do të sjellim një personazh me karakteristika të veçanta, i cili nuk bën pjesë drejtpërdrejt në Policinë e Kosovës, mirëpo ndikon dhe tashmë ka lënë shenjë në formësimin dhe edukimin profesional të pjesëtarëve të policisë sonë. Sapo takohesh me të fillon të flasë për Policinë e Kosovës dhe këtë e bën me një entuziazëm të madh sikur flet për diçka personale të saj. Fjala është për znj. Roksan Bejleri bullgaro-shqiptarja e cila përkthen për të gjitha ekipet shqipfolëse, pjesëmarrëse në trajnimet për zbatim të ligjit në Akademinë ndërkombëtare të zbatimit të Ligjit në Budapest. Përmes kësaj qendre ajo vite më parë ka krijuar kontaktet e para me pjesëtarë të Policisë së Kosovës dhe ato tashmë janë të vazhdueshme dhe ndërtohen gjithnjë shumë e më shumë. Ajo është lindur dhe rritur në Bullgari dhe ndërkohë studimet i ka përfunduar në Universitetin e Tiranës, ku ka përfunduar magjistraturës dhe studimet e doktoraturës në fushën e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe momentalisht ajo punon si shefe e Katedrës në Universitetin e Sofjes në fakultetin e Gjuhës shqipe, në kuadër të këtij universiteti dhe me vite ka studiuar dhe hulumtuar çështje të ndryshme të gjuhës shqipe të cilën e njeh skajshmërisht mirë, që pas kontaktit me të do ta kishte zili secili shqiptar që gjuhën shqipe e ka gjuhë të nënës. Që në takimin e parë me të ajo të krijon përshtypjen e një personi që ka gatishmërinë dhe vullnetin për të komunikuar dhe për të ndihmuar aq sa do të kishte mundësi duke bërë shpesh të pamundurën. Kur komunikon me të ajo me shumë respekt kujton kohën dhe trajnimet që ka punuar dhe ka ndihmuar në përkthime



pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe flet me respekt dhe konsideratë për secilin. Ajo me vite ka ruajtur prezantimet që kanë bërë ekipet e Policisë së Kosovës në këtë qendër dhe i kujton si të arritura dhe gjithmonë thotë se niveli i këtyre prezantimeve duhet të rritet. Edhe pse detyra e saj në këtë qendër është përkthimi, ajo kujdeset shumë për pjesëmarrësit kosovarë në këtë qendër, duke qenë se me vite është prezent aty. Shembull, kur organizohen evente që ndërlihen me Kosovën, darka nacionale e Kosovës, pa dyshim roli i saj është i pashmangshëm duke i dhënë ide dhe sugjerime stafit vendor që punon në qendër për dukjen e sallës, llojin e ushqimit kosovar dhe traditat tona. Pa dyshim që secili prej nesh ka fjalë të mira dhe respekt për këtë zonjë të nderuar dhe do të jemi falënderues për çdo gjë që ajo ka bërë për ne gjatë asaj kohe të qëndrimit atje.



KURIOZITETE



Hajduti profesionist pasi vodhi bizhuteritë e zë gjumi në krevat

Një hajdut ka surprizuar punonjësen e një shtëpie, pasi ndërsa kishte marrë një sasi të konsiderueshme bizhuterish, e kishte zënë gjumi në krevatin që ndodhej në një prej dhomave. Ai është shtrirë, duke menduar se nuk ndodhej asnjë person në shtëpi, por në fakt e ka pësuar duke përfunduar në prangat e policisë.

Pastruesja e shtëpisë ka qënë ajo e cila ka sinjalizuar policinë, e cila pasi kishte mbërritur në shtëpinë e grabitur, i ka bërë edhe një foto hajdutit i cili ishte ende në gjumë.

Bëhet fjalë për Dion Davis, 29 vjeç, i cili kishte vjedhur një qese plot bizhuteri në një shtëpi në Florida. Policia ka bërë me dije se vlera e bizhuterive të vjedhura arrinte në 6000 paund.

Harron fëmijën 6-muajsh në makinë, policia paralajmëron nënën

Një nënë e papërgjegjshme, e cila kishte harruar fëmijën 6 muajsh në makinë, ka marrë paralajmërim nga policia, për neglizhencë. Ka qënë policia e cila kishte parë fëmijën teksa qante, ndërsa nëna e tij po bënte disa blerje në një qëndër tregtare. Fatmirësisht, fëmija është në gjendje të mirë shëndetësore. 29-vjeçar, por pas disa minutash u bind që ta merrte xhemperin.



Ja si përfundoi një hajdut kur vjedh në Brazil

Plani i tij nuk ka shkuar aspak mirë, pasi një hajdut në Brazil jo vetëm që nuk ka grabitur gjë, por ka marrë edhe dëmtime të konsiderueshme në trup. Ndonëse tentoi të ngjitej në tarracë për ti shpëtuar banorëve, ai nuk ka mundur dot të largohet, pasi tarraca është dëmtuar. Jo vetëm banorët e grabitur, por edhe ai në fund ka përfunduar brënda një banese. Në përpjekje për t'i shpëtuar pronarëve të banesave, hajduti zgjodhi që të largohej nëpërmjet çatave të shtëpive. Banorët ndonëse të dëmtuar, kanë arritur të kapin hajdutin, i cili më pas është arrestuar.



Harron drogën në taksi, arrestohet kur raporton çantën e humbur



Një 39 vjeçar nga Anglia nuk është treguar aspak i kujdesshëm me çantën që ai posedonte, ndërsa në të kishte një sasi të konsiderueshme lënde narkotike. Teksa ai e kishte me nxitim, e kishte harruar çantën në një taksi. Shoferi i cili e

përcolli deri në destinacionin e duhur kishte hapur çantën, e ku në të kishte gjetur lëndën narkotike. Pas lajmërimit, policia mbërriti menjëherë në vendin e ngjarjes për të investiguar se kujt mund t'i përkiste. I riu është kthyer të

nesermen në stacionin e taksive për të kërkuar çantën, pa e ditur që policia po bënte hetime. Ai tashmë është vënë në pranga dhe sipas policisë, vlera e drogës së gjetur brenda çantës ishte rreth 2000 paund.

Ngatërruan numrin e telefonit, çifti humb shpërblimin për kapjen e vrasësit

Një person i cili akuzohej për përdhunimin e më pas vrasjen e një gruaje është kapur nga policia, në sajë të dhënave të përcjella nga një çift, i cili fatkeqësisht nuk ka marrë shpërblimin. Të gjithë personat të cilët jepnin ndonjë të dhënë, shpërblimi do të ishte i majmë, por ja që çifti në fjalë nuk ka shijuar asnjë monedhë. E gjithë kjo situatë, në fakt ndodhi për faj të një gabimi të vogël, që më vonë rezultoi fatal. Një çift i cili ndihmoi policinë në kapjen e një personi që dyshohej për vrasje, nuk kanë marrë dot shpërblimin prej 10 mijë paund, sepse në vend që të telefononin policinë kundër krimeve, telefonuan rajonin e policisë. Çifti ka dhënë informacionin e saktë për

policinë, duke bërë të mundur në kapjen e autorit. Ata u shprehën se policët që arrestuan vrasësin morën shpërblimin prej 5 mijë paund, veprim i cili sipas tyre nuk ishte i drejtë.



Njeriu më fisnik në botë

E shikoni këtë burrë të vjetër. Ai është një ndër njerëzit më të mirë në botë. Ju mund të pyesni përse ne themi kështu? Ai quhet Dobri Dobrev dhe është 99 vjeç. Ai e humbi dëgjimin e tij në luftën e dytë botërore. Ai prej disa dekadash bën rrugë të gjatë rreth 25 kilometër në ditë në këmbë. Ai është nga Bullgaria. Dhe ai është një lypës i mirëfilltë.

Çuditërisht Dobrev nuk lyp për veten, ai ja del mbanë me një pension prej 80 Eurosh të mbijetojë më së miri. Të gjitha lekët që ai i ka mbledhur me kalimin e viteve nga e lypja, ai i ka dhuruar për disa jetimore të zonës. Ai nuk e mban një cent nga të gjitha paratë që ai fiton.

Përgatiti: Çajup Kajtazi

FOTOLAJM

FOTOGRAFI



Policia e Kosovës ka festuar 15 vjetorin e themelimit

